Prof. Asoc. **Fabian Zhilla**
Dr. **Iv Rokaj**
Dr. **Ivas Konini**

STUDIME NË KRIMINOLOGJI

Vëllimi I

STUDIME
NË
KRIMINOLOGJI

Vëllimi I

Autorët:
Prof. Asoc. Dr. Fabian Zhilla
Dr. Iv Rokaj
Dr. Ivas Konini

Drejtuese e Projektit: Alba Jorganxhi

ISBN:

Ky botim u mundësua nga:

OSCE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Ky projekt mbështetet financiarisht nga:

Parathënie

Ky botim është mbështetur nga projekti "Për krijimin e programit 'Master në Kriminologji'" (2018-2024), i cili zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, me mbështetjen financiare të Byrosë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri falënderon autorin për punën e tij dhe shpreh përkushtimin e saj të vijueshëm për promovimin e hulumtimit shkencor dhe debatit akademik në fushën e kriminologjisë.

PËRMBAJTJA

Prof. Asoc. Fabian Zhilla

JURISPRUDENCA NDËRKOMBËTARE VLEFSHMËRIA E PROVAVE TË KOMUNIKIMEVE TË KODUARA

(EncroChat dhe SKY ECC)

Profesor i Asocuar Fabian Zhilla

Pedagog i të Drejtës, Instituti Kanadez i Teknologjisë (CIT)

Fabian.Zhilla@cit.edu.al

Abstrakt:

Ky artikull bën një radiografi të të gjithë jurisprudencës së gjykatave më të larta të disa vendeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe Mbretërisë së Bashkuar duke u përpjekur të sjell në mënyrë të përmbledhur argumentet kryesore të këtyre gjykatave në lidhje me vlefshmërinë e përdorimit të mesazheve të koduara të marra nga EncroChat dhe SKY ECC. Në këtë artikull është përfshirë edhe mendimi i Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Formati i këtij studimi është organizuar në mënyrë të tillë që të ndihmojë të gjithë palët e interesuara në hetimin, gjykimin dhe analizimin të këtyre materialeve hetimore që është një risi në procesin penal. Duhet cilësuar vështirësia e hasur në përkthimin e vendimeve të gjykatave, e cila nuk është kryer nga përkthyes të certifikuar dhe në këtë kontekst, ky aspekt duhet konsideruar si një kufizimi i këtij artikulli. Nga ana tjetër, duke qenë se fenomeni i përdorimit të telefonave dhe aplikacioneve që ofrojnë komunikime të koduara është një çështje e re ligjore, punimet akademike në këtë drejtim janë shumë të limituara, dhe për këtë arsye i gjithë studimi është fokusuar në organizimin dhe sjelljen në formë sistematike të jurisprudencës aktuale të gjykatave të sipër cituara, pa përfshirë në të një qëndrim specifik të autorit.

Fjalët kyçe: Komunikimet e koduara (EncroChat dhe SKY ECC), përdorshmëria e provave, ndihma e ndërsjelltë juridike, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

HYRJE

Në dekadën e fundit ka pasur një rritje të përdorimit të pajisjeve telefonike të cilat ofrojnë komunikime të koduara të cilat ju mundësojnë përdoruesve anonimitetin dhe konfidencialitetin e mesazheve të tyre. Ky lloj funksioni specifik i tyre solli një kërkesë në rritje të përdorimit të këtyre pajisjeve nga krimi i organizuar por dhe zyrtarëve me funksione të larta publike. Nga ana tjetër, përdorimi i tyre solli një zhvillim të ri edhe në sofistikimin e kryerjes së veprave penale në kuadër të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke sjellë edhe vështirësi të konsiderueshme në hetimin e tyre. Sidoqoftë, pas një periudhë gati pesë vjeçare të përdorimit të tyre, autoritetet ligjzbatuese franceze dhe holandeze arritën që të aksesojnë dhe bëjnë të mundur dekodimin e mijëra mesazheve të komunikimeve nëpërmjet EncroChat në vitin 2020, duke sjellë edhe arrestimin e një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të organizatave kriminale në Bashkimin Evropian (BE)[1] por dhe në Ballkanin Perëndimor[2], ku përfshihen edhe grupet kriminale shqiptare.[3]

Pas dekodimit të këtyre mesazheve, sfida tjetër e agjencive ligjzbatuese ishte përdorimi i tyre si mjete prove në kërkesat për masat e

1 Shih njoftimin zyrtar të Europol datë 02 korrik 2022 këtu: https://www.eurojust.europa.eu/news/dismantling-encrypted-netëork-sends-shockëaves-through-organised-crime-groups-across-europe

2 Shh njoftimin zyrtar të Europol datë 13 maj 2023 këtu: https://www.europol.europa.eu/media-press/neësroom/news/balkans-biggest-drug-lords-arrested-after-investigation-encrypted-phones

3 Shi Ivana Jeremic, Milica Stojanovic and Samir Kajosevic "*Encrypted Phone Crack No Silver Bullet against Balkan Crime Gangs*", BIRN, 25 prill, 2022, këtu: https://balkaninsight.com/2022/04/25/encrypted-phone-crack-no-silver-bullet-against-balkan-crime-gangs/

sigurimit dhe gjykimit në themel të çështjeve gjyqësore. Tashmë çështje të cilat përfshijnë prova të mbështetura në komunikimet e EncroChat dhe Sky ECC janë gjykuar dhe po gjykohen në gjykata të ndryshme të disa vendeve të BE-së dhe jashtë saj në rajon, si Francë, Gjermani, Itali, Mbretëri e Bashkuar, Norvegji, Serbi etj.

Hetime dhe kërkesa për gjykim të cilat janë mbështetur në komunikimet e EncroChat dhe Sky ECC janë kryer edhe nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (Prokuroria e Posaçme) ku më i njohuri ndër to është hetimi për të ashtuquajturin "*Operacioni Metmorfoza*" në të cilin u kërkuan masa sigurimi "arrest me burg" për 15 persona, ku ndër të tjera përfshihen si të dyshuar anëtarë dhe drejtues të një prej organizatave kriminale më të fuqishme në rrethin e Shkodrës, biznesmen të njohur, punonjës të policisë së shtetit të nivelit të lartë drejtues, dhe përfaqësues të sistemit të drejtësisë.[4]

Duke u nisur nga përdorimi gjithnjë e më në rritje të këtyre materialeve hetimore nga agjencitë ligjzbatuese në BE dhe Struktura e Posaçme Hetimore kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ky punim synon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të gjykatave në shtete të ndryshme të BE por dhe ato të Mbretërisë së Bashkuar për të kuptuar më qartë qasjet e ndryshme të mbajtura nga këto gjykata në lidhje me standardin e provueshmërisë për këto materiale hetimore. Për vetë natyrën deri diku të pazakontë të këtyre materialeve hetimore, ky studim do të ndahet në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë, do të bëhet një përmbledhje e pretendimeve të ngritura nga palët mbrojtëse dhe qëndrimet që kanë mbajtur gjykatat e ndryshme të vendeve të BE dhe ato të Britanisë së Madhe në kundërshtimin apo miratimin e tyre në lidhje me përdorimin dhe vlefshmërinë e komunikimeve EncroChat dhe Sky ECC në gjykimin penal. Pjesa e dytë i referohet zhvillimeve më të fundit në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Pjesa e tretë do të konkludojë më një përmbledhje të të gjitha argumenteve të jurisprudencës të cituar në

4 Shih njoftimin zyrtar të SPAK, datë 28 korrik 2023, këtu: https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-28-07-2023/

këtë punim, duke i organizuar ato sipas çështjeve kryesore juridike të ngritura nga palët mbrojtëse.

Nga pikëpamja metodologjike, ky studim do të aplikojë një nga metodat cilësore të kërkimit shkencor në fushën e jurisprudencës, siç është ajo që njihet si "metoda analitike" ligjore. Duke qenë se objekti i këtij studimi është të analizojë dhe sintetizojë interpretimet e ndryshme të gjykatave të shteteve të ndryshme dhe atyre të brendshme, kjo lloj metode shkencore ofron mundësinë e ekspozimit të argumenteve ligjore mbi aspekte të paqarta të ligjit siç në rastin konkret është ajo e standardit të provës për komunikimet telefonike të koduara. [5]

I. JURISPRUDENCA NDËRKOMBËTARE

Që në krye të herës duhet cilësuar se ka një qëndrim që sa vjen edhe konsolidohet nga gjykatat më të larta të disa prej vendeve të BE, të cilat janë ballafaquar më gjykimin e pranueshmërisë si mjete prove të materialeve hetimore të cilat rrjedhin nga të dhënat e marra prej bisedave të koduara, kryesisht nga telefonat EncroChat dhe aplikacioni SKY ECC.[6] Argumentet thelbësore të këtyre gjykatave do të trajtohen në seksionin në vijim.

Në ndryshim nga seksioni i parë i këtij punimi, formati i këtij seksioni do të organizohet duke u orientuar në argumentet kryesorë të vendimeve të gjykatave sipas shteteve përkatëse të BE. Kjo strukturë është organizuar e tillë, në mënyrë atipike për një punim akademik, me qëllim që ti vij në ndihmë jo vetëm studiuesve të kësaj fushe por dhe praktikuesve të ligjit, kryesisht gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve

5 Shih Ishaara, P, Bhat, 'Analytical Legal Research for Expounding the Legal World', Idea and Methods of Legal Research (Delhi, 2020; online edn, Oxford Academic, 23 Jan. 2020), https://doi.org/10.1093/oso/9780199493098.003.0006.

6 Një përmbledhje e disa vendimeve mund të gjendet në një studim të Parlamentit Evropian në dhjetor 2022 që mund të aksesohet këtu: https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2022/739268/EPRS_ATA(2022)739268_EN.pdf

mbrojtës, oficerëve nga shërbimet e policisë gjyqësore, hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, etj.

FRANCË

Vendimi i mëposhtëm i Gjykatës së Kasacionit në Francë është vendimi kyç prej të cilit rrjedhin më pas të gjitha argumentet e gjykatave në vendet e tjera të BE. Për këtë qëllim, në trajtimin e këtij vendimi do të përfshihen si pretendimet e mbrojtjes por dhe argumentet përkatës të gjykatës.

Dhoma Penale, Gjykata e Kasacionit, çështje nr. 21-85.148, datë 11 tetor 2022

Rasti ka të bëjë me një hetim penal në shtetin francez në kuadër të krimit të organizuar. Gjatë hetimit, autoritetet franceze vendosen një pajisje në disa telefona e EncroChat dhe serverët e kompanisë në të cilën mblidheshin të dhënat (a) të ruajtura në çdo aparat celular apo server në atë kohë dhe (b) dërgoheshin ose merreshin nga çdo aparat celulari më pas. Agjencitë ligjzbatuese zbuluan se të akuzuarit përdornin komunikime të koduara për veprimet e tyre kriminale.[7] Të akuzuarit identifikoheshin gjithashtu me kodet e tyre përkatëse. Nga të dhënat e mbledhura u vërtetua se disa nga të hetuarit ishin përfshirë në trafikun e narkotikëve dhe armëve.[8] Një nga të akuzuarit e apeloi çështjen duke ngritur disa pretendime të cilat janë përmbledhur në vijim[9]:

7 Mundësia e instalimit të një pajisjeje të tillë u mundësua nga autoritetet franceze me ligjin e 14 marsit 2011 me qëllim për të bërë të mundur çmontimin e grupeve kriminale që përdorin teknika i sofistikuar komunikimi. Konkretisht, kjo pajisje, e cila përfshin instalimin e spyëare brenda një sistemi kompjuterik, duhet të bëjë të mundur kapjen, nëse është e nevojshme nëpërmjet monitorimit, jo vetëm të skedarëve të kompjuterit nga një hard disk ose media e lëvizshme (siç është çelësi USB), por edhe të teksteve të shtypura në tastierë ose imazheve që shfaqen në ekran.

8 Lexo vendimin e Gjykatës këtu: https://www.conseil-constitutionnel.fr/les-decisions/decision-n-2022-987-qpc-du-8-avril-2022-decision-de-renvoi-cass

9 Ibid,

Pretendimi i parë i mbrojtjes:

Mbrojtja argumentoi se kapja e të dhënave digjitale nga një rrjet i koduar ishte e paligjshme, në shkelje të së drejtës së jetës private dhe familjare si dhe në kundërshtim të nenit 706-102-1 të Kodit të Procedurës Penale,[10] veçanërisht në lidhje me marrjen e të dhënave të ruajtura në kompjuter dhe përgjimin e të dhënave në transit.[11] Mbrojtja

10 Neni 706-102-1 i Kodit të Procedurës Penale Franceze ndodhet në Seksionin 6 të Kapitullit 6 të Titullit 2 të Kodit të Procedurës Penale të Francës. Ky neni rregullon çështjet që lidhen me kapjen dhe regjistrimin e të dhënave kompjuterike në kuadër të hetimit penal. Ky nen rregullon mënyrën se si organet hetimore mund të kryejnë kapjen e të dhënave kompjuterike në kuadër të hetimit penal, duke caktuar kufizimet dhe procedurat që duhet të ndiqen në këtë proces. Me poshtë përafrimi i nenit te përkthyer:
Neni 706-102-1 (Për Kapjen e të Dhënave Kompjuterike):
"Kur është e nevojshme për hetime për veprat penale të përcaktuara në nenet 706-102 dhe 706-102-2, organet e hetimit, nën autoritetin e autoriteteve kompetente gjyqësore, kanë të drejtë të marrin masat e nevojshme për kapjen e të dhënave të ruajtura në një kompjuter ose një sistem të të dhënave elektronike.
Kapja e të dhënave të tjera, të veprimit ose të dërguara me anë të një sistemi të komunikimit elektronik, lejohet vetëm nëse janë të lidhura me të dhëna të ruajtura.
Për qëllimet e këtij neni, të dhëna të ruajtura janë të dhënat që janë ruajtur, të regjistruara, ose të regjistruara dhe ruajtura brenda një sistemi kompjuterik ose elektronik, për të cilin është kryer një kapje teknike për qëllimet e hetimit.
Kapja dhe përdorimi i të dhënave të kapura janë të ndaluar në qoftë se organi hetimor informohet se te dhënat janë krijuar ose përdorur në mënyrë të paditur.
Kjo kapje dhe përdorim nuk mund të përdoren për qëllime tjera se ato të shprehura në urdhrin e autorizuar nga gjyqtari i udhëtimit.
.....
Hyrja në mjetet e tjera të ruajtura të cilat janë të lidhura me sigurinë kombëtare është e ndaluar. Megjithatë, për qëllimet e të dhënave të kapura, dhe përkatësisht të çfarëdo informacioni të duhur, ato mund të përdoren nga struktura përkatëse e Ministrisë së Brendshme në pajtim me dispozitat e Kodit të Mbrojtjes Kombëtare dhe me miratimin e Ministrisë së Brendshme."

11 Këto dispozita u përfshin në me ligjin e 3 qershorit të vitit 2016 për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar.

pretendonte se disa veprime teknike të kryera nga agjencitë ligjzbatuese, si bllokimi i operacioneve së të dhënave (block operations) i cili bllokon qarkullimin e të dhënave ndërmjet ofruesve të ndryshëm dhe veprimeve që bëjnë ridrejtimin e të dhënave (data flow redirection), konsiston nga pikëpamja teknike, në ndryshimin e rregullave të rrugëzimit të rrjetit (network routing rules), dhe sipas saj kjo ndërhyrje konsiderohet "përgjim" i të dhënave dhe si rrjedhojë është në tejkalim të nenit të mësipërm.

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

Argumentimi i Gjykatës:

Gjykata hodhi poshtë argumentin e mbrojtjes, duke deklaruar se ligji nuk bën dallime midis llojeve të ndryshme të të dhënave digjitale nga një rrjet i koduar. Gjykata thekson se veprimet e organit hetimor në kapjen e këtyre të dhënave kishin si qëllim që të parandalonin administratorët e bisedave të koduara për të kryer kodimin e mesazheve të subjekteve nën hetim. Gjykata arsyetoi se veprimet e organit hetimor ishin në kuadër të masave teknike të cilat kishin si qellim mbledhjen e këtyre të dhënave dhe në këtë kontekst, këto veprime ishin tërësisht në përputhje me ligjin.

Sipas gjykatës vendosja e pajisjes për kapjen e të dhënave sipas nenit të mësipërm lejohet vetëm për vepra penale të kryera në kuadër të krimit të organizuar, dhe nëse te dhënat e mbledhura kanë lidhje me vepra penale të tjera ato nuk mund të jenë të përdorshme përballë gjykatës [12]. Në rastet e hetimit të krimit të organizuar, gjyqtari hetues lejon vendosjen e pajisjeve për "kapjen e të dhënave" vetëm pasi merr një mendim nga prokurori i çështjes. Pajisja lejon aksesin në të dhëna, regjistrimin, ruajtjen dhe transferimin e tyre pa nevojën e marrjes së pëlqimit e palëve të interesuara ose nën vëzhgim. Këto pajisje teknike

12 Lexo opinionin ligjor të avokatit Olivier Gutkes "Digital Evidence in Criminal Law", këtu: https://www.ecba.org/extdocserv/conferences/tallinn2012/recdev_france.pdf

mund të instalohen në një kompjuter ose një telefon celular por mund të vendosen edhe në distancë.

Pretendimi i dytë:

Mbrojtja pretendoi se në gjykim nuk ishin shqyrtuar të gjitha provat pasi nuk ishin përfshirë të gjitha dokumentet që duheshin shqyrtuar që në fazën e gjykimit në themel dhe si rrjedhojë, mungesa e tyre kishte cenuar procesin e drejtë ligjor.

Argumentimi i Gjykatës:

Gjykata deklaroi se ky pretendim nuk qëndronte pasi i gjithë dokumentacioni i duhur ishte përfshirë në gjykim. Gjykata gjithashtu nënvizoi se mbrojta ka pasur të gjitha mundësitë dhe të drejtat për të kërkuar përfshirjen dhe vlerësimin e ligjshmërisë së tyre që në fazën e gjykimit në themel.

Pretendimi i tretë (këtu do ndalemi më shumë për shkak të rëndësisë):

Përpara së të parashtrojmë pretendimin e tretë të mbrojtjes duhet të sqarojmë bazën ligjore mbi të cilat mbrojtja ngre pretendimin e saj siç parashikohet në nenin 230 të Kodit të Procedurës Penale Franceze. Në paragrafin e parë të tij (neni 230-1), ligji i jep të drejtë organit procedues që në rastet kur duket se të dhënat e sekuestruara ose të marra gjatë procesit të hetimit janë ndryshuar, duke penguar aksesin ose kuptimin që përmbajnë të dhënat e mbledhura, organi procedues mund të caktojë një ekspert të licencuar për të kryer veprimet e nevojshme teknike për të mundësuar marrjen e një versioni të lexueshëm të tij dhe gjithashtu, kur është përdorur një metodë kodimi, të mundësoj gjithashtu çelësin sekret për dekodimin e tij. Organi procedues, për vepra penale të dënueshme me burgim mbi dy vjet por edhe në rastet kur kompleksiteti i hetimit e justifikon, gjithashtu mund të urdhërojë dhe përdorimin e mjeteve të konsideruar si sekret shtetëror për ta marrë këtë informacion sipas procedurave të parashikuara në nenin 230-2. Në varësi të detyrimeve të sekretit shtetëror, rezultatet shoqërohen me udhëzime teknike që mundësojnë kuptimin dhe përdorimin e tyre, si dhe me lëshimin e një

raporti/certifikate vërtetësie i cili vërteton autencitetin e rezultateve të përgatitura nga eksperti i caktuar prej organit procedues (neni 230-3).[13]

(Argumenti i parë i mbrojtjes):

Mbrojtja argumentoi se përdorimi i mjeteve shtetërore që i nënshtroheshin sekretit shtetëror ishte i parregullt dhe shkelte të drejtat dhe liritë e njeriut, kjo për faktin se nuk kishte asnjë kontroll *apriori* ose *posteriori* që rregullonte këtë vendim diskrecional që ligji i jep organit procedues. Sipas mbrojtjes, këto veprime ishin të pajustifikuara dhe jo proporcionalë ndaj të drejtave dhe lirive kushtetuese.

(Argument i dyte-Informacioni Teknik dhe Certifikata e Vërtetësisë):

Mbrojtja argumentoi se edhe nëse janë përdorur mjete që i nënshtrohen sekretit shtetëror, rezultatet e marra duhet të shoqërohen me tregues teknike të dobishme për kuptimin dhe përdorimin e tyre, si dhe një certifikate të nënshkruar nga eksperti i licencuar që vërteton vërtetësinë e mesazheve të transmetuara. Mungesa e kësaj certifikate përbente shkelje të nenit 230-3 të Kodit të Procedurës Penale Franceze.

Kushtetutshmëria

Arsyetimi i Gjykatës mbi Kushtetutshmërinë:

Gjykata vuri në dukje se testi i kushtetutshmërisë se nenit 706-102-1 të Kodit Francez të Procedurës Penale dhe se Këshilli Kushtetues e kishte gjetur fjalinë e dytë të paragrafit të dytë të nenit 706-102-1 në përputhje me Kushtetutën, ashtu siç dilte edhe në ligjin nr. 2019-222 i datës 23 mars 2019.

Arsyetimi i Gjykatës mbi Informacionin Teknik dhe lëshimin e Certifikatës:

Gjykata u shpreh se ligji i parashikon këto kërkesa, por ato i

13 Shiko Kodin Procedural Penal Francez në anglisht këtu: https://sherloc.unodc.org/cld/uploads/res/document/fra/2006/code_of_criminal_procedure_en_html/France_Code_of_criminal_procedure_EN.pdf

nënshtrohen detyrimeve që rrjedhin në kuadër të ruajtjes së sekretit shtetëror. Gjykata shtoi se sipas procedurës së parashikuar në ligj Qendra për Luftën kundër Krimit Kibernetikë ka të drejtë të kundërshtojë kufizimet që lidhen me mbrojtjen e sekretit shtetëror në ato pika që lidhen me kërkesat për shpjegime të natyrës teknike. Megjithatë, Gjykata vërejti se ky pretendim nuk ishte objekt i gjykimit të saj, duke pranuar se certifikata e vërtetësisë duhej të ishte përfshirë në dosjen hetimore komfor ligjit procedural.

Si përfundim Gjykata e Kasacionit nuk e konsideroi "kapjen e të dhënave" si përgjim, dhe nuk e konsideroi përfshirjen e certifikatës së vërtetësisë si instrument thelbësor procedural i cili cenonte thelbin e vlefshmërisë së të dhënave të marra nga organi procedues.

GJERMANI

Vendimi i Gjykatës së Lartë Federale Gjermane, 2 mars 2022, çështja nr. 5 StR 457/21

Gjykata Rajonale e Hamburgut dënoi një të akuzuar për kryerjen e veprave penale në fushën e narkotikëve më të paktën 5 vite burgim dhe urdhëroi dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale me vlerë prej më shumë se 70.000 euro. I akuzuari e apeloi vendimin në Kolegjin e Pestë Penal të Gjykatës Federale në Leipzig në vitin 2021. I dënuari gjatë veprimtarisë kriminale kishte komunikuar duke përdorur EncroChat për të organizuar trafikun e drogës. Këto mesazhe u përdorën në gjykatë si provë thelbësore për provueshmërinë e akuzave. Në apelin e tij, i akuzuari ngrinte pretendimin se mesazhet nëpërmjet EncoChat, të cilat i ishin përcjelle organit të akuzës nga autoritetet franceze nuk mund të pranoheshin prej tyre dhe të përdoreshin si mjete prove.

Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm Publik Federal, çështja kaloi për gjykim në Gjykatën e Lartë Federale Gjermane e cila rrezoi pretendimet e mbrojtjes. Gjykata e Lartë u shpreh se të dhënat e ofruesit EncroChat të përcjella nga autoritet franceze mund të përdoren si provë,

nëse i shërbejnë qëllimit të hetimit të veprave penale të rënda. [14]

Gjykata shprehet prerë duke thënë se "*Përjashtimi i provave që pretendohet në ankim të jenë marrë në mënyrë të parregullt dhe në shkelje të ligjit nuk qëndron nga çdo këndvështrim juridik*", duke argumentuar si me poshtë:

Kushtetushmëria

Gjykata shprehet se:

- "*Përdorimi i të dhënave të marra në një mënyrë të ngjashme me këtë rast mund të përfshijë një shkelje të respektimit të jetës private i cili mbrohet nga neni 10 i Ligjit Bazë (Grundgesetz, GG); prandaj, për arsye kushtetuese duhet që me kujdes të merret parasysh parimi i propocionalitetit. Duke iu referuar kufizimeve të përdorimit të provave sipas seksionit 100e (6) nr. 1 StPO, të dhënat e marra në këtë mënyrë mund të përdoren për të dënuar autorët që kanë kryer vepra penale veçanërisht të rënda, për hetimin e të cilëve, gjykata mund të lejojë përdorimin e teknikave hetimore të cilat mund të jenë edhe më ndërhyrëse se zakonisht në jetën private të të dyshuaritt dhe të cilat janë të parashikuara nga legjislacioni procedural penal, siç mund të jenë përkatësisht një kërkim në internet ose një vëzhgim zanor në ambientet private të personit nën hetim. Dhe në çështjen konkrete, kemi të bëjmë me një hetim të një vepre penale të rëndë siç është trafiku i lëndëve narkotike*".

Ndihma e ndërsjelltë juridike

Gjykata shprehet se:

- "*Mbledhja e provave nuk cenon vlerat themelore të të drejtave të njeriut, ato evropiane ose parimet themelore kushtetuese në kuptimin*

14 Shiko vendimin e plotë të Gjykatës këtu: https://www.bundesgerichtshof.de/SharedDocs/Pressemitteilungen/EN/2022/2022038.html

e një "ordre public" (urdhër që mund të cenonte moralin dhe rendin publik-shënimi i autorit) që duhet të marr parasysh në ndihmën e ndërsjelltë juridike. Sipas informacionit që autoritetet franceze kishin marrë nga aksesi i tyre i parë në këto të dhëna, hetimet nuk kishin të bënin me një vëzhgim masiv/të përgjithshëm të kryer pa shkak dhe që përfshinte një numër të madh përdoruesish të telefonave celularë dhe për të cilat nuk ekzistonte asnjë dyshim për ta. Në fakt, për autoritetet franceze EncroChat rezultoi të ishte një platformë që ishte ndërtuar që në krye të herës për të lehtësuar veprimtarinë e grupeve kriminale të cilët vepronin në fshehtësi. Për shkak të konstatimeve fillestare se këta telefona përdoreshin pothuajse ekskluzivisht për qëllime kriminale, një përdorues, vetëm nëpërmjet përdorimit të EncroChat i cili kushton shumë dhe nuk mund të blihet si telefonat e zakonshëm, dyshohej se po kryente vepra penale në kuadër të krimit të organizuar, si trafik të lëndëve narkotike, trafik armësh apo pastrim të produkteve penale".

Testi i përputhshmërisë me legjislacionin e brendshëm

Gjykata shprehet se në rastin konkret:

- "*Nuk do të kryhet një vlerësim i ligjshmërisë sipas legjislacionit të huaj të teknikave të hetimit të përdorura nga autoritetet franceze. Si rezultat, nuk ka shumë rëndësi nëse një mjet hetimor i ndërmarrë në Francë sipas legjislacionit francez mund të ishte lejuar ose jo edhe në Gjermani. Kjo nuk përbën një parakusht për transferimin në procedimin penal gjerman të provave të marra nga autoritetet franceze sipas legjislacionit francez. Kërkesat e ndryshme për urdhërimin e një mase të tillë në Francë dhe Gjermani mund të kompensohen me vlerësimin që mund ti bëhet përdorimit të provave në gjykatë. Për këtë arsye, siç edhe u citua më lartë në paragrafin a), për vepra penale të rënda zbatohen kërkesat veçanërisht të larta për përdorimin e kësaj prove".*

Detyrimi për të njoftuar autoritetet gjermane dhe mbizotërimi i interesit shtetëror

Në këtë pikë Gjykata nënvizon se:

- "*Nuk do të konsiderohet shkak për përjashtimin e marrjes së provave detyrimi që mund të kenë autoritetet franceze për të informuar në kohë autoritetet gjermane në lidhje me veprimet hetimore të vëzhgimit në territorin federal, duke pasur parasysh miratimin e mëvonshëm të përdorimit të të dhënave nga të gjitha palët. Pavarësisht kësaj, është e diskutueshme nëse detyra për të njoftuar palën gjermane do t'i shërbejë individualisht personave të interesuar për të diskutuar ligjshmërinë e përdorshmërisë së provave në gjykatë. Megjithatë, në çdo rast, në një çështje penale, një gjykim i duhur mbi përplasjen e interesave të ndryshme do të duhet të çoj në dhënien përparësi interesit të shtetit. Nuk ngre asnjë shqetësim ligjor fakti që Zyra e Prokurorisë në Frankfurt ka kërkuar një transferim të të gjithë provave në procedimet kundër personave të panjohur (pra jo vetëm për rastin konkret-shënim i autorit) bazuar në një dyshim që ishte i përgjithshëm, por që në fund të fundit do të zbatohej për përdoruesit specifik për secilin rast*".

Shkelje të procedurës në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Gjykata shprehet se pala mbrojtëse:

- "*nuk ka argumentuar ndonjë shkelje të rregullave që lidhen me ndihmën e ndërsjelltë ligjore gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave ose ndryshe gjatë bashkëpunimit midis autoriteteve policore franceze dhe gjermane përpara se të lëshohej Urdhri Evropian i Hetimit. Prandaj është e parëndësishme që, për shkak se pëlqimi është marrë më pas, mbi të gjitha, nuk vërehet ndonjë gabim drastik ligjor i dukshëm, pasi rregulloret evropiane mbi ndihëm e ndërsjelltë juridike e lejojnë transferimin ndërkufitar të gjetjeve për qëllime të ndjekjes penale edhe në mungesë të një kërkese zyrtare në formë shkresore. Në çdo rast, përdorimi i të dhënave që rrjedhin nga kjo formë shkëmbimi të dhënash nuk mund t'i nënshtrohet kërkesave më të rrepta se ato që zbatohen për përdorimin e të dhënave të marra nëpërmjet një Urdhri Evropian*

Hetimi. Një shmangie e synuar apo sistematike nga autoritetet franceze ose gjermane e rregulloreve të cilat do ti shërbenin mbrojtjes ligjore të të akuzuarve as nuk është ngritur nga mbrojtja në mënyrë të qartë dhe as nuk është realisht e dukshme."

NORVEGJI

Vendimi i Gjykatës së Lartë Norvegjeze, datë 04 nëntor, 2022, çështja nr. 22-156788STR-HRET[15]

Në këtë çështje tre persona akuzohen për trafik të lëndëve narkotikë në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Prokuroria e ka mbështetur provueshmërinë e faktit penal kryesisht në të dhënat e marra nga autoritetet Franceze, nga bisedat e koduara nëpërmjet të kryera nga të akuzuarit nëpërmjet EncroChat. Pala mbrojtëse ka kërkuar që këto materiale të mos administroheshin duke filluar me këtë pretendim që në shkallën e parë dhe duke e apeluar me të njëjtin pretendim edhe në gjykatën e apelit si dhe në Gjykatën e Lartë. Qoftë, Gjykata e Shkallës së Parë në Oslo por dhe Gjykata e Apelit të Borgarting në vitin 2022 i rrëzuan këto pretendime duke i konsideruar materialet e marrë nga autoritetet franceze të vlefshme.

Pretendimet e palës mbrojtëse për dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë ishin se Gjykata e Apelit ka supozuar gabimisht se provat ishin të ligjshme dhe të marra në zbatim të legjislacionit penal francez, duke argumentuar se Gjykata e Apelit ka keqinterpretuar vendimin e Gjykatës së Kasacionit në Francë. Mbrojtja gjithashtu pretendonte edhe shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke argumentuar se avokatit mbrojtës iu mohua aksesi në të gjithë zinxhirin e lëvizjes së provave materiale.

15 Shih v**endimin e plotë të Gjykatës këtu:** https://www.domstol.no/globalassets/upload/hret/decisions-in-english-translation/hr-2022-2125-u.pdf

Kriteret e pranueshmërisë së provave nga autoritetet e huaja

Gjykata e Lartë i rrëzon pretendimet e palës mbrojtëse duke sqaruar fillimisht se kriteret që duhet të plotësohen që materialet hetimore e përcjella nga autoritetet e huaja të jenë të pranueshme janë:

- " i) *Materialet hetimore duhet të jenë marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin përkatës (Francë), (ii) i pandehuri duhet të ketë akses në të gjitha të dhënat e marra dhe (iii) të dhënat nuk duhet të jenë marrë sipas një procedure e cila bie ndesh me vlerat themelore të shoqërisë norvegjeze. Një ndalim i përdorimit të materialeve të marra nga autoritetet e huaja si provë do të ishte veçanërisht i rëndësishëm kur procedura e mbledhjes se provave kryhet nga shtete në të cilat traditat procedurale penale ndryshojnë nga tonat*."[16]

Legjitimiteti i provave

Pretendimi kryesor i palës mbrojtëse lidhej me legjitimitetin e administrimit të atyre provave, procedura e të cilave sipas legjislacionit procedural të vendit dërgues (Franca), nuk është e qartë ose nuk ka një parashikim të shprehur ligjor për to. Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje, Gjykata e Lartë nënvizoji argumentet e Gjykatës së Apelit që ajo i gjente të drejta dhe në përputhje me legjislacionin penal norvegjez. Kështu Gjykata e Apelit shprehet se:

- "*Nuk përbën rëndësi për këtë çështje, nëse të njëjtat materiale mund të paraqiten si prova në një gjykatë franceze. Pranimi i materialeve si provë në një gjykatë franceze varet nga një sërë faktorësh procedural të ndryshëm nga vetë marrja e tyre. Nuk ka rëndësi vendimtare për këtë çështje, cilido qoftë rezultati në çështjen gjyqësore franceze në lidhje me përjashtimin ose jo të këtyre materiale si prova. Referuar jurisprudencës norvegjeze, edhe vetë Gjykata e Apelit nuk ka shumë hapësirë interpretimi në lidhje me ligjshmërinë e provueshmërinë*

16 Ibid, paragrafi 26 i Vendimit të Gjykatës së Apelit të Borgarting, datë 21 tetor 2022.

së provave, e tillë që të kërkojë pajtueshmëri me procedurën penale franceze në trajtimin e mëvonshëm të provave që tashmë janë marrë prej këtyre autoriteteve. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, marrja e provave nuk mund të konsiderohet e paligjshme, sepse një rregull shkelet në një fazë të mëvonshme siç është moslëshimi i një certifikate vërtetësie. Në mendimin e Gjykatës së Apelit, termi "kapje/marrje" të dhënash sipas legjislacionit penal francez (që është përdorur për këto biseda-shënimi i autorit) nuk ka të bëjë me (procedurën ku kërkohen-shënimi i autorit) lëshimet e mëvonshme të certifikatave të vërtetësisë ose çdo vërtetim tjetër të nevojshëm sipas ligjit francez."[17]

ITALI

Gjykata e Kasacionit, datë 5 prill 2023, nr. 16347

Në këtë çështje, gjykata e themelit të rajonit të Kalabrisë ka dhënë vendimin e masës së sigurimit personal "arrest me burg" duke u mbështetur në përmbajtjet e komunikimeve të koduara nëpërmjet aplikacionit SKY ECC. Këto të dhëna ishin marrë nga prokurori publik italian prej autoritetit gjyqësore franceze nëpërmjet një Urdhri Evropian Hetimi. Mbrojtja e kundërshtoi vendimin e gjykatës ku ndër të tjera pretendoi se **i)** janë shkelur ligjet që rregullojnë shkëmbimin e dokumentacionit mbi të cilat organi procedues mbështeti kërkesën për ndihmë të ndërsjelltë juridike **ii**) aktet e marra nga autoritetet franceze janë të papërdorshme pasi janë në shkelje të Konventës së Budapestit dhe është shkelur gjithashtu procedura dekodimit të bisedave nga autoritetet franceze, si mungesa e lëshimit të një certifikate vërtetësie për dekodimin e bisedave **iii**) pamundësia e mbrojtjes për tu njohur me procesin e dekodimit të bisedave dhe **iv**) mungesa e dyshimit i arsyeshëm për kryerjen e një krimi, bazuar në fakte dhe të dhëna objektive.

Disa nga argumentet e gjykatës të cilat rrëzojnë kundërshtimin e palës mbrojtëse nënvizojnë se:

17 Ibid, paragrafi 26 i Vendimit të Gjykatës së Apelit.

Legjitimiteti i të dhënave

- "*Të dhënat e marra janë plotësisht të përdorshme..... Në këtë rast, të dhënat nuk janë kërkuar nga një subjekt privat (për shembull, SKY GLOBAL i cili menaxhonte platformën në fjalë përpara shkeljes së saj nga policia e huaj), por nga një autoritet gjyqësor i cili, në kuadër të një procedimi tjetër dhe të pavarur, i kishte marrë këto të dhëna nga serveri ku ishin ruajtur si pjesë e një hetimi tjetër..... Në lidhje me këtë rindërtim, pra, duket krejtësisht e papërshtatshme të flitet për pëlqim, më tepër që duhet të verifikohet nëse, në lidhje me legjislacionin e brendshme, kushdo që ka transmetuar të dhënat mund t'i disponojë në mënyrë legjitime ato. Dhe përgjigja nuk mund të jetë tjetër veçse pozitive, gjithmonë në kufijtë e vlerësimit të përputhshmërisë me parimet themelore të sistemit tonë ligjor, pasi veprimtaria e marrjes së të dhënave është zhvilluar nën drejtimin e një gjyqtar*i (Gjykata e Parisit)"...

Gjykata për këtë argument konkludon se:

- *"Në përfundim, duhet theksuar se ... nuk ka rëndësi për vlerësimin e legjitimitetit të urdhrit të ankimuar nëse këto të dhëna janë mbledhura nga autoritetet gjyqësore franceze ex post ose në kohë reale (d.m.th. si të "të dhëna të ftohta" ose si "rrjedha komunikimi") . Në fakt, kur autoritetet italiane kërkuan marrjen e këtyre të dhënave dhe (aq më tepër) kur ato të dhëna iu transmetuan, flukset e komunikimit sigurisht që nuk ishin më të vazhdueshme. Situata, pra, nuk ishte e ndryshme nga ajo që ndodh kur një rrjedhë komunikimesh, të shkruara ose në imazhe, të ruajtura në kujtesën e një telefoni merret ex poste. Në këto raste, jurisprudenca ka vlerësuar vazhdimisht se dispozitat e neneve 266 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të aplikohen (pasi këto nene aktivizohen) vetëm kur synohet të veprohet duke iu referuar flukseve të vazhdueshme të komunikimit.."* (paragrafi 3.3. i Vendimit*).*

Marrja e të dhënave në ruajtje statike (të ftohta)

Gjykata shprehet se mbrojta:

- **"***ngatërron çështjen e autenticitetit të të dhënave të deshifruara me atë të garancisë së integritetit të zinxhirit të procedurës së ndjekur. Në këtë pikë është e rëndësishme të ritheksohet atë që tashmë është bërë e qartë në vendime të tjera të kësaj Gjykate në rastet e hetimit paraprak se: procedura e marrjes së të dhënave në ruajtje (të përcaktuara si të ftohta) ose përgjimi i të dhënave telematike në tranzit lejon marrjen, nëse të dhënat elektronike të mesazhit kodohen përmes përdorimit të një algoritmi ose një çelësi enkriptimi dhe shndërrohen në të dhëna të thjeshta kompjuterike, një varg kompjuterik i përbërë nga një kod binar. Në këtë rast - siç është thënë tashmë – ligjshmëria e mesazhit i nënshtrohet veprimtarisë së dekodimit, që presupozon disponueshmërinë e algoritmit që lejon kthimin e kodit binar në një përmbajtje të lexueshme, por çdo mesazh të enkriptuar që lidhet me çelësin e tij të dekriptimit, pasi vetëm çelësi i saktë do të prodhojë një dekodim të saktë ....*

- *tashmë është bërë e njohur, si në lidhje me deshifrimin e mesazheve me sistemin Blackberry (d.m.th. , "pin to pin" dhe jo "end to end"), si në rastin konkret që përdorimi i algoritmit përjashton mundësinë e ndryshimeve ose manipulimit të teksteve të marra, pasi, sipas shkencës kompjuterike, ai lejon riprodhimin besnik të tyre, me përjashtim të lidhjes së elementeve specifike dhe konkrete me të kundërtën. Për më tepër, pikërisht për mesazhet e shkëmbyera nëpërmjet sistemit të koduar "SKY ECC" dhe "EncroChat", është theksuar se dekodimi i bisedave dhe komunikimeve është një aktivitet i ndryshëm nga grumbullimi i tyre , këto të dhëna përbëjnë shpërfaqen e komunikimeve në një bazë materiale digjitale, d.m.th. janë të dhëna kompjuterike që lejojnë kuptueshmërinë e përmbajtjes së fjalëve të shkruara në vargje në një sistem binar*. " (paragrafi 4 i Vendimit).

Ndihma e ndërsjelltë juridike

Siç theksuam më lart, një ndër argumentet thelbësore të mbrojtjes ishte shkelja e procedurave të marrjes se provave në kuadër të Urdhrit Evropian të Hetimit.

Në këtë pikë gjykata argumenton se:

- "*Prokurori publik italian nuk i ka kërkuar autoritetit gjyqësor të një shteti tjetër anëtar të BE-së që të zhvillojë një hetim, por ka vepruar në përputhje me nenin 45 të dekretit të përmendur (Kërkesë për dokumentacion në lidhje me telekomunikacionet), me qëllim të kufizuar për të kërkuar dhënien e dokumentacionit të grumbulluar, i cili është kërkuar nëpërmjet Urdhrit Evropian të Hetimit. Këto të dhëna janë mbledhur me iniciativën e pavarur të autoritetit lëshues për një procedim që kryhej në atë vend.*

- *Në kuadër të një procedimi që lidhet me një Urdhër Evropian Hetimi garantimi i të drejtave themelore të njeriut i takon kryesisht shtetit anëtar lëshues, i cili presupozohet se është respektues i legjislacionit të BE, sidomos të të drejtëve themelore të njeriut.*

- *Në çështjen në shqyrtim, Urdhri Evropian i Hetimit duhet të përmbajë vetëm kërkesën për provën specifike, duke ia lënë në kompetencë shtetit ekzekutues, procedurën e brendshme të marrjes së provës. ... Gjykata e hetimit paraprak vuri në dukje se nga dokumentacioni i përcjellë ishte e mundur verifikimi i mënyrës së marrjes dhe e ruajtjes së të dhënave nga autoriteti gjyqësor francez* (paragrafi 3 i Vendimit)..

- *.... është e rëndësishme të risillet në vëmendje parimi i përgjithshëm i prezumimit të legjitimitetit të provave të marra nga autoriteti gjyqësor i një shteti tjetër anëtar të BE.. përdorimi i dokumenteve të transmetuara, në fakt, nuk kushtëzohet nga një vlerësim i gjyqtarit italian në lidhje me rregullsinë e mënyrës së marrjes së të dhënave të kryera nga autoriteti i huaj, pasi në këtë rast zbatohet prezumimi i legjitimitetit të veprimtarisë së kryer. Dhe ky proces është në kompetencën e gjyqtarit të huaj për të bërë verifikimin e korrektësisë*

së ndjekjes së procedurës dhe zgjidhjen e mundshme të çdo çështjeje në lidhje me parregullsitë e kundërshtuara ne apel në fazën e hetimit paraprak.... Prandaj, duhet ripërsëritur ajo që tashmë është shprehur nga Gjykata e Themelit se barra e provës u takon atyre që kundërshtojnë mungesën e përputhshmërisë së procedurave të autoriteteve gjyqësore të huaja me ato të sistemit të brendshëm, sidomos kur bëhet fjalë, si në rastin konkret, me legjislacioni e një vendi anëtar të BE të mbështesin pretendimin e tyre .."(paragrafi 5 i Vendimit).

MBRETËRIA E BASHKUAR

Vendimi i Gjykatë së Apelit A, B, D & C dhe REGINA datë 05/02/2021[18]

Çështja thelbësore që shtrohej përpara gjykatës ishte nëse komunikimet u përgjuan në momentin kur ato po transmetoheshin ose, siç konstatoi gjyqtari në gjykatën e themelit, u nxorën (përgjuan) nga ruajta (storage) qoftë e pajisjes telefonike të përdoruesit por dhe serverëve. Për qëllimin e këtij punimi do të ndalojmë vetëm në analizën që Gjykata i ka bërë procesit të "përgjimit" dhe "ruajtjes", në paragrafët 63-69 të vendimit të gjykatës.

Procesi i ruajtjes së të dhënave

Sipas gjyqtarit në gjykimin e themelit, kuptimi i "ruajtjes" nënkupton se:

- "*komunikimet janë ekstraktuar drejtpërdrejt nga pajisja e përdoruesit dhe jo gjatë lëvizjes së tyre, përmes ose nga ndonjë pjesë tjetër e sistemit të komunikimit. Ky është një proces i ngjashëm me çdo mënyrë tjetër të shkarkimit të përmbajtjes së të dhënave në një celular. Kjo bëhet në distancë, por bëhet edhe duke i dhënë komandën përkatëse RAM-it e celularit (memorjes), pa qenë e nevojshme të kryhet përgjimi*

18 Shih vendimi e plotë të Gjykatës së Apelit këtu: https://www.bailii.org/ëë/cases/EËCA/Crim/2021/128.pdf

i komunikimit pasi ai ka lënë telefonin. Në rastin e dërguesit, materialet u rikthyen në formë mesazhesh të dekoduara të ruajtura në RAM të pajisjes në një formë në të cilën ekzistonin para se të dërgoheshin nga telefoni në serverat që ndodhesin në Roubaix (të Francës-shënimi i autorit), përmes sistemit të telekomunikacionit."

Me tej Gjykata e Apelit sqaron se:

- "*duke pasur parasysh këtë interpretim për kuptimin e procesit të "ruajtjes", nuk është e nevojshme të përcaktohet kur fillon dhe përfundon procesi i transmetimit. Ne nuk e pranojmë se transmetimi i mesazhit filloi kur përdoruesi shtypi komandën "Dërgo". Ky ishte një veprim që shkaktoi pajisjen të përgatisë mesazhin në formën e tij përfundimtare dhe pastaj të nisë procesin e transmetimit. Një celular është një kompjuter dhe një transmetues. Transmetimi ndodh pasi mesazhi është vendosur nga kompjuteri në formën e tij përfundimtare. Në rastin e tanishëm, kjo përfshin edhe procesin e kodimit. Ky (kodim) ndodh pasi përdoruesi shtyp komandën "Dërgo", e cila ndodh përpara se mesazhi të transmetohet nga pajisja. Pas pranimit nga pajisja e pranuesit, ai dekriptohet në RAM dhe mund të ndodhë që në disa raste të shtohet një emër i përdoruesit në mesazhin që është transmetuar, i cili ruhet në bazën e të dhënave (Realm) në atë pajisje. Ne mendojmë që transmetimi është i plotë kur komunikimi mbërrin në pajisjen e pranuesit, kështu që pajisja mund të fillojë punën për ta dekriptuar dhe bërë mesazhin të lexueshëm. Edhe në këtë sistem të pazakontë, transmetimi ndodh, në lidhje me çdo komunikim, kur një pajisje është në kontakt me pjesën tjetër të sistemit për qëllimin e dërgimit ose marrjes së një komunikimi, dhe kur komunikimi lëviz nëpër pjesë të tjera të sistemit*.[19]

- *Mesazhi është ai që transmetohet. Ajo që mbetet në pajisje nuk është ajo që është transmetuar, por një kopje e saj ose ajo që, në format më të hershme të mesazheve, mund të përshkruhet si "draft". Kjo ndodh menjëherë pas transmetimit kur merret kopja, ose edhe nëse kopja është*

19 Gjyqtari i themelit bën një shpjegim teknik të të gjithë procesit i cili gjendet në paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Apelit.

ekstraktuar ndërsa transmetimi i mesazhit origjinal të koduar vazhdon ende. Fakti që ajo që u mor është një mesazh i paprekur, do të thotë se ajo që ishte në telefon, dhe ajo që është kapur, nuk janë të njëjta me atë që është transmetuar, sepse ajo që është transmetuar është e koduar. Prandaj (mesazhi i intereferuar nga autoritetet franceze-shënimi i autorit) nuk ishte në procesin e "transmetimit" kur është kapur por ka qenë vetëm në "ruajtje"....

Gjykata konkludon se:

- *"....pyetja e vetme thelbësore ...është nëse materialet e EncroChat ishin të ruajtura në sistemin e telekomunikacionit kur ato u interferuan. ... ne mendojmë se këto mesazhe nuk po transmetoheshin por ishin të ruajtura (gjatë kohës së ndërhyrjes nga autoritetet franceze-shënim i autorit)"*

HOLANDË

Referuar dy profesorëve të ligjit në Universitetin e Utrecht, (Oerlemans dhe D.A.G. van Toor), autoritetet gjyqësore holandeze janë shprehur se gjykatat e brendshme nuk kanë pse gjykojnë legjitimiteti i provave që janë marrë nga organet e huaja të zbatimit të ligjit, përveç se jemi përballë shkeljes së procesit të rregullt ligjor. Si shembull autorët sjellin vendimin e Gjykatës së Roterdamit e cila nënvizon se:

- " *Autoritetet gjyqësore franceze kanë autorizuar përdorimin e mjetit të përgjimit dhe kanë marrë garancitë e nevojshme. Ndërkohë Prokuroria holandeze theksoi vazhdimisht se procedimi penal i ishte drejtuar një kompanie në territorin francez'. (...) Për këtë arsye, dhe duke iu referuar parimit të besimit në këto çështje, Gjykata nuk do të shqyrtojë legjitimitetin e urdhrit të një gjyqtari francez*".[20]

20 .J. Oerlemans and D.A.G. van Toor (2022) "Legal Aspects of the EncroChat Operation: A Human Rights Perspective", *European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice*, 30(3-4), 309-328.

II. QASJA SIPAS TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PENALE

Është ende herët të konkludohet se kush do të jetë interpretimi e gjykatave evropiane, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) mbi vlefshmërinë e përdorimit të të dhënave të marra nga platformat e komunikimit të koduar si ato të EncroChat dhe SKY ECC. Një kërkesë e është drejtuar GJDBE nga Gjykata Rajonale e Berlinit datë 19 tetor 2022, (525 KLs) 279 Js 30/22 (8/22) dhe një kërkesë i është drejtuar GJEDNJ nga dy shtetas britanik në dt. 5 tetor 2020 (aplikimi nr.44715/20) dhe 20 shtator 2021(aplikimi nr.47930/21).[21] Më poshtë do të trajtojmë kërkesat e Gjykatës Rajonale të Berlinit dhe parashtrimet e Avokatit të Përgjithshëm të GJDBE për këtë çështje.

Kërkesa drejtuar Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)

Menjëherë pas vendimit të dhënë të Gjykatë së Lartë Federale Gjermane në datë 25 mars të vitit 2022 që cituam më sipër, 7 muaj më pas, Gjykata Rajonale e Berlinit do ti drejtohet GJDBE bazuar në parimin e supremacisë së ligjit të BE.[22] Gjykata më e ulët e justifikoi këtë qasje duke arsyetuar se:

"*Ishte fshehtësia e komunikimit (të autoriteteve gjermane-shënim i autorit) me Europolin dhe Eurojust-in që solli që shumë gjykata të larta rajonale gjermane të përfshiheshin në dhënien e masave të sigurimit me "arrest me burg", duke supozuar gabimisht se të dhënat u ishin transmetuar autoriteteve gjermane "spontanisht" dhe pa nxitjen ose pjesëmarrjen gjermane në nxjerrjen e këtyre të dhënave ....Gjykatat nuk ishin në dijeni paraprakisht për përfshirjen e autoriteteve gjermane.... Dokumentet në lidhje me këtë - si procesverbalet e konferencës dhe*

21 Shih të gjithë pretendimet e ngritura në njoftimin e bërë zyrtar në faqen e GJEDNJ këtu: https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-214862%22]}

22 Shiko nenin 19 dhe nenin 267 paragrafi 3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian.

mesazhet e SIENA-s - u morën vetëm më pas nga avokatët mbrojtës; Prandaj, ato nuk u morën parasysh në vendimin e Gjykatës Federale të Drejtësisë të datës 2 mars 2022 (5 StR 457/21 - juris Rn. 21 ff.) dhe ende nuk merren parasysh nga zyra e prokurorit publik.....”[23]

Gjykata Rajonale e Berlinit (Landgericht Berlin) me vendimin **datë 19 tetor 2022, (525 KLs) 279 Js 30/22 (8/22)** pezulloi gjykimin ndaj një të pandehuri, i cili ishte subjekt i ndjekjes penale për trafik narkotikësh bazuar në të dhënat e EncroChat. Gjykata ngrinte dyshimin nëse marrja e të dhënave nga autoritetet gjermane prej autoriteteve franceze, nëpërmjet një Urdhrit Evropian te Hetimit (UEH/EIO), ishte e ligjshme ose jo dhe nëse këto të dhëna mund të përdoreshin si prova gjatë procedimit penal të rastit konkret. Kështu Gjykata Rajonale e Berlinit i drejtoi 14 pyetje GJDBE ku për qëllim të këtij artikulli, do ti grupojmë ato sipas çështjeve ligjor që kanë nevojë për interpretim.[24] Ndër të tjera Gjykata Rajonale e Berlineit ngre këto pyetje:

- A mund të mbështetet në ligj aktivizimi i nenit 6(1)(b) i Direktivës UEH/EIO e cila njeh të drejtën e lëshimit të një UEH/EIO në rastet kur kemi të bëjmë më të dhëna të transmetuara nëpërmjet komunikimeve telefonike, kur procedura e mbledhjes së këtyre të dhënave mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e shtetit kërkues (Gjermanisë) për një çështje të ngjashme? [25]

- Bazuar në **parimin e efektivitetit** sipas ligjit të BE-së[26] a mund

23 Shih Vendimin e Gjykatës LG Berlin, Beschl. 19.10.2022 – (525 KLs) 279 Js 30/22 (8/22), paragrafi 31, këtu: https://www.burhoff.de/asp_weitere_beschluesse/inhalte/7384.htm

24 Shih analizën e plote të Fairtrails “German courts refer the legality of EncroChat evidence to the CJE”, të përditësuar në 08 nëntor 2022, këtu: https://www.fairtrials.org/articles/legal-analysis/german-courts-refer-the-legality-of-encrochat-evidence-to-the-cjeu/#background-98

25 Shih, Ibid, këtu: https://www.fairtrials.org/articles/legal-analysis/german-courts-refer-the-legality-of-encrochat-evidence-to-the-cjeu/

26 Parimi i efektivitetit, ose mbrojtja gjyqësore efektive, detyron gjykatat e shteteve anëtare të sigurojnë që mjetet juridike kombëtare dhe rregullat procedurale nuk i bëjnë kërkesat e bazuara në ligjin e BE-së të pamundura në praktikë ose tepër të vështira për t’u zbatuar. Ky parim një parim

të kërkohet përjashtimi i provave të marra me anë të një UEH/EIO që është në kundërshtim me ligjin e BE-së?

- Sipas **parimit të ekuivalencës** të legjislacionit të BE-së[27] a mundet përdorimi i provave të konsiderohet i paligjshëm nëse mënyra (masa) me të cilën është marrë kjo provë në shtetin ekzekutues do të ishte e paligjshme për një çështje të njëjtë sipas procedurës penale të brendshme të shtetit lëshues, përkatësisht Gjermanisë?

- A mund të konsiderohet shkelje e legjislacionit të BE-së, veçanërisht **parimit të efektivitetit**, nëse përdorimi i provave të marra në kundërshtim me legjislacionin e BE-së në procedimet penale justifikohet në kontekstin e një balancimi të interesave duke u nisur nga rëndësia e veprës penale, fakt që nuk dihej fillimisht përgjatë mbledhjes së provave?

- Si alternativë, **bazuar në parimin i efektivitetit** të ligjit të BE-së, nëse marrja e provave nuk mund të përjashtohet, a duhet të merren parasysh shkeljet e mësipërme së paku në nivelin e vlerësimit të provave ose të merren në konsideratë në dhënien e dënimit nga gjykata në procesin penal të brendshëm, kjo edhe në rastin e hetimeve për vepra penale të rënda? [28]

---

përdoret shpesh nga GjED për të siguruar autoritetin e ligjit të BE-së mbi ligjin kombëtar. Për më shumë shih M. Elvira Mendez-Pinedo, 2021. "The principle of effectiveness of EU law: a difficult concept in legal scholarship," *Juridical Tribune (Tribuna Juridica*), Bucharest Academy of Economic Studies, Law Departament, vol. 11(1), pages 5-29, March. .

27 Parimi i ekuivalencës kërkon që shtetet anëtare të mos i trajtojnë çështjet sipas ligjit të BE-së në mënyrë më pak të favorshme sesa çështjet e trajtuara sipas legjislacionit të brendshëm. Pra një shtetas i BE duhet të përdori të njëjtat instrumente procedural sikurse ata vendas në legjislacionin e brendshëm. Ky parim u sanksionua në vitin 1976 në cështjen *Rewe-Zentralfinanz eG and Rewe-Zentral AG v Landwirtschaftskammer für das Saarland*, nr. 33/76 që mund të aksesohet këtu: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A61976CJ0033

28 Shih analizen e plote të Fairtrails "German courts refer the legality of EncroChat evidence to the CJE", të përditësuar në 08 nëntor 2022, këtu: https://www.fairtrials.org/articles/legal-analysis/german-courts-refer-the-legality-of-encrochat-evidence-to-the-cjeu/#background-98

Për përgjimin e komunikimit telefonik pa ndihmën e një Shteti Anëtar (neni 31 i Direktivës së UEH/EIO**)**

- Sipas kuptimit të nenit 31 të Direktivës së UEH/EIO, a mund të konsiderohet "përgjim i komunikimit telefonik", kur në rastin konkret përfshihet infiltrimi i terminaleve (pajisjeve) për mbledhjen e trafikut, vendndodhjes dhe të dhënave të komunikimit të një shërbimi komunikimi të bazuar në internet?

- A duhet që njoftimi i parashikuar në nenin 31(1) të Direktivës së UEH/EIO t'i drejtohet gjithmonë një gjyqtari ose të paktën nëse sipas ligjit të shtetit të njoftuar (Gjermania), masa e parashikuar nga shteti monitorues (Franca) mund të urdhërohej vetëm nga një gjyqtar në një çështje të ngjashme të brendshme?

- Përderisa neni 31 i Direktivës së UEH/EIO i shërben gjithashtu mbrojtjes individuale të përdoruesve të telekomunikacionit në fjalë, a shtrihet kjo mbrojtje edhe në përdorimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale në shtetin e njoftuar (Gjermani)? Përveç kësaj, nëse po, a është ai qëllim i barabartë me objektivin tjetër të mbrojtjes së sovranitetit të Shtetit Anëtar të njoftuar?

Kur bëhet fjalë për pasojat e një shkelje të mundshme të ligjit të BE, në mënyrë të përmbledhur Gjykata Rajonale e Berlinit , nënvizon se principet themelore të BE-së, si efikasiteti dhe ekuivalenca, të interpretuara më parë nga vendimet e GJDBE, kufizojnë autonominë procedurale të vendeve anëtare, veçanërisht në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me marrjen dhe pranimin e provave.

Në rastin konkret që po shqyrtohet, gjykata ka përcaktuar se shkelja e këtyre parimeve të BE mund të çoj në mos pranimin e këtyre provave. Arsyetimi i gjykatës rajonale për këtë vendim është i fokusuar tek mungesa e transparencës e organeve hetimore në mënyrën dhe procedurën e ndjekur për nxjerrjen e këtyre të dhënave. *Së pari*, mungesa e transparencës nga ana e agjencive ligjzbatuese franceze të cilat nuk kanë treguar formën teknike të ndërhyrjeve në pajisje e cila e ka bërë të pamundur vlerësimin e vërtetësisë së të dhënave. *Së dyti*,

refuzimi i agjencive të BE dhe autoriteteve gjermane të zbatimit të ligjit për ti dhënë akses mbrojtjes në një pjesë të dosjes.[29]

OPINIONI I AVOKATIT TË PËRGJITSHËM TË GJDBE

Një qasje paraprake duket se do të merret nga GJDBE pas Opinionit të Avokatit të Përgjithshëm, znj. Tamara Ćapeta, të lëshuar në datë 26 tetor 2023, argumentet e të cilit do të përmblidhen më poshtë. Duhet cilësuar se parashtrimet e Avokatit të Përgjithshëm nuk janë të detyrueshme për Gjykatën por ato kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në orientimin e vendimit të saj. Për më tepër, parashtrimet e Avokatit të Përgjithshëm ndjekin të njëjtat parime të dhënies së një vendimi gjykate si paanshmëria, pavarësia dhe arsyetimi.[30]

Që në krye të herës, Avokati i Përgjithshëm sqaron se nuk ishin UEH/EIO të lëshuara nga autoritetet gjermane ato të cilat nxitën autoritetet franceze për të përgjuar komunikimet e kryera nëpërmjet EncroChat. Këto të dhëna u kapën nga autoritetet franceze në mënyrë të pavarur dhe sfida në lidhje me legjitimtetin e procesit të përgjimit të këtyre të dhënave i takon gjykatave kompetente franceze. Si rrjedhim UEH/EIO e lëshuara nga autoritetet gjermane, nuk kishin si objekt mbledhjen e të dhëna përmes përgjimit telefonik në Francë, por synimi i tyre ishte vetëm që të kryhej transferimi i provave të mbledhura tashmë nëpërmjet përgjimit të kryer nga autoritetet franceze në mënyrë autonome. Dhe ky synim është në përputhje të plotë me nenin neni 1(1) i Direktivës së UEH/EIO. Me pak fjalë "*një UEH/EIO mund të lëshohet ose për mbledhjen e provave të reja ose për transferimin e provave ekzistuese"* dhe në rastin konkret UEH/EIO *"u lëshua për rastin e dytë*"(paragrafët 16-20; shiko gjithashtu paragrafët 56-57 të konkluzionit të ndërmjetëm).

Më pas Avokati i Përgjithshëm cilëson se "*Do të doja ta bëja të qartë*

29 Shih Thomas Wahl, "EncroChat Turns into a Case for the CJEU", *EUCRIM*, Issue 3/2022, p.197-198, këtu: https://eucrim.eu/news/encrochat-turns-into-a-case-for-the-cjeu/

30 Shiko nenin 253 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian.

që në fillim, dhe do ta shtjelloj këtë më vonë, se në një skenar të tillë, autoriteti lëshues nuk mund të vërë në dyshim ligjshmërinë e masave me të cilat shteti ekzekutues kryen mbledhjen e provave."(paragrafi 22 i Opinionit). Në mbështetje të këtij argumenti, Avokati i Përgjithshëm nënvizon se "*Megjithëse sistemet e së drejtës penale të Shteteve Anëtare ndryshojnë ndjeshëm, kjo nuk do të thotë se një sistem penal i mbron të drejtat themelore të të dyshuarve dhe të akuzuar ndërsa një tjetër i shkel ato. Përkundrazi, bashkëpunimi i ndërsjëlltë gjyqësor në BE-së në çështjet penale mbështetet në supozimin se të gjitha Shtetet Anëtare respektojnë të drejtat themelore. Ndërsa ky supozim mund të rrëzohet para gjykatës kompetente në një rast të caktuar, kjo nuk mund të vërë në pikëpyetje parimin e besimit të ndërsjellë që qëndron në themel të UEH/EIO dhe instrumenteve të tjera të bashkëpunimit në çështjet penale*"(paragrafi 51).

Avokati i Përgjithshëm konkludon duke interpretuar nenet përkatëse të Direktivës së UEH/EIO si më poshtë:

Kushtet dhe autoriteti kompetentet për lëshimin e një UEH/EIO (neni 6 i Direktivës)

- Kur në shtetin ekzekutues një masë është autorizuar nga një gjyqtar, një UEH/EIO për transferimin e provave të tilla nuk kërkon që ajo të lëshohet domosdoshmërisht gjithashtu nga një gjyqtar, edhe nëse sipas ligjit të shtetit lëshues mbledhja e provave do të duhej të urdhërohej fillimisht me vendim gjykate.

- Fakti që përgjimi është kryer në territorin e një shteti tjetër anëtar nuk përbën ndonjë kusht për përcaktimin e institucionit autorizues në shtetin lëshues.

- Ligji i BE-së nuk kërkon që një UEH/EIO për transferimin e provave ekzistuese të mbledhura përmes përgjimit të telekomunikacionit të lëshohet nga një gjykatë, nëse ligji i brendshëm parashikon që një prokuror publik të mund të urdhërojë një transferim të tillë në një çështje të ngjashme vendase (lexo nga një gjykatë vendase në tjetrën

brenda sistemit të brendshëm gjyqësor).

- Vlerësimi i domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të një UEH/EIO që kërkon transferimin e provave ekzistuese është një çështje që i takon autoritetit lëshues që ta kryejë nëpërmjet shqyrtimit nga një gjykatë e brendshme kompetente. Një vlerësim i tillë duhet të marrë parasysh se qasja e autoritetit kombëtar në të dhënat e komunikimit të përgjuar përfaqëson ndërhyrje serioze në jetën private të personave në fjalë. Kjo ndërhyrje duhet të kundër-balancohet nga interesi serioz publik në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve.

- Kur lëshohet një UEH/EIO për transferimin e provave tashmë në posedim të një shteti tjetër, referenca për një çështje të ngjashme të brendshme sipas nenit 6(1)(b) të Direktivës 2014/41/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 3 prill 2014 në lidhje me UEH/EIO në çështjet penale kërkon që autoriteti lëshues të përcaktojë nëse dhe në cilat kushte ligji i brendshëm procedural penal lejon transferimin e provave të mbledhura përmes përgjimit të komunikimit.

- Kur vendoset nëse mund të lëshohet një UEH/EIO për transferimin e provave ekzistuese, autoriteti lëshues nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë e mbledhjes së provave në shtetin ekzekutues, transferimi i të cilave kërkohet nga UEH/EIO përkatëse.

- Fakti që masat u ndërmorën në territorin e shtetit lëshues, ose ishin në interes të atij shteti, nuk ndikon në përgjigjen e mësipërme.

Interpretimi i nenit 31(1) dhe (3) i Direktivës (Njoftimi i shtetit anëtar)

- Një Shtet Anëtar i cili, gjatë hetimit ose procedurës së tij të njëanshme penale, përgjon telekomunikacionet në territorin e një Shteti tjetër Anëtar, duhet të njoftojë atë shtet tjetër për kryerjen e këtij përgjimi.

- Ky njoftim mund t'i dërgohet çdo autoriteti që shteti anëtar i përgjimit e konsideron të përshtatshëm, pasi ai shtet nuk mund të dijë se cili autoritet është kompetent në një çështje të ngjashme të brendshme.

• Neni 31 i Direktivës 2014/41 ka për qëllim të mbrojë si përdoruesit individualë të telekomunikimit në fjalë, si dhe sovranitetin e Shtetit Anëtar të njoftuar.

Përdorimi i provave

• Legjislacioni i BE, në këtë fazë të zhvillimit të tij, nuk rregullon pranueshmërinë e provave të cilat janë marrë nëpërmjet një UEH/ EIO të lëshuar në kundërshtim me kërkesat e Direktivës 2014/41. Pranueshmëria e provave është një çështje e ligjit të brendshëm, i cili, megjithatë, duhet të jetë në përputhje me nenet 47 dhe 48 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

III. KONKLUZION

Më poshtë do të bëjmë një përmbledhje të standardeve të vendosura deri tani nga jurisprudenca e gjykatave të cituara më lart duke i organizuar ato sipas çështjeve ligjore të pretenduara nga palët mbrojtëse:

Ndryshimi midis marrjes/kapjes së të dhënave dhe përgjimit

• Komunikimet janë ekstraktuar drejtpërdrejt nga pajisja e përdoruesit dhe jo gjatë lëvizjes së tyre, përmes ose nga ndonjë pjesë tjetër e sistemit të komunikimit. Ky është një proces i ngjashëm me çdo mënyrë tjetër të shkarkimit të përmbajtjes së të dhënave nga një telefon celular (Angli).

• Mesazhi është ai që transmetohet. Ajo që mbetet në pajisje nuk është ajo që është transmetuar, por një kopje e saj ose ajo që, në format më të hershme të mesazheve, mund të përshkruhet si "draft".(Angli);

• Mesazhet që ndodhen në telefon dhe mesazhet që janë kapur, nuk janë të njëjta me ato që janë transmetuar, sepse mesazhi i transmetuar është i koduar. Prandaj mesazhi i intereferuar nga autoritetet francezenuk ishte në procesin e "transmetimit" kur është kapur por ka qenë vetëm në "ruajtje"....(Angli).

- Të dhënat janë marrë kur nuk ka pasur fluks transmetimi por kur ato kanë qenë statike (Itali).

- Dekodimi i bisedave dhe komunikimeve është një aktivitet i ndryshëm nga grumbullimi i tyre, këto të dhëna përbëjnë shpërfaqen e komunikimeve në një bazë materiale digjitale, d.m.th. janë të dhëna kompjuterike që lejojnë kuptueshmërinë e përmbajtjes së fjalëve të shkruara në vargje në një sistem binar (Itali).

Kriteret e marrjes së të dhënave

1. Provat duhet të jenë marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin lëshues (Norvegji).

2. I pandehuri duhet të ketë akses në të gjitha të dhënat e marra (Norvegji).

3. Të dhënat nuk duhet të jenë marrë sipas një procedure e cila bie ndesh me vlerat themelore të shoqërisë norvegjeze(Norvegji).

Legjitimiteti i marrjes së të dhënave nga autoriteti i huaj

- Marrja e provave nuk mund të konsiderohet e paligjshme, sepse një rregull shkelet në një fazë të mëvonshme siç është moslëshimi i një certifikate vërtetësie(Norvegji).

- Procesi i "kapjes/marrjes" së të dhënave sipas legjislacionit penal francez (nuk ka të bëjë me kërkesën për lëshimin e certifikatës së vërtetësisë) (Norvegji).

- Të dhënat nuk janë kërkuar nga një subjekt privat (për shembull, SKY GLOBAL i cili menaxhonte platformën në fjalë përpara shkeljes së saj nga policia e huaj), por nga një autoritet gjyqësor i cili, në kuadër të një procedimi tjetër dhe të pavarur, i kishte marrë nga serveri ku ishin ruajtur këto të dhënat si pjesë e një hetimi tjetër (Itali).

Testi i përputhshmërisë me legjislacionin e brendshëm

- Nuk ka shumë rëndësi nëse një mjet hetimor i ndërmarrë në Francë sipas legjislacionit francez mund të ishte urdhëruar ose jo edhe në Gjermani. Kjo nuk përbën një parakusht për transferimin e provave

të marra nga autoritetet franceze sipas ligjit francez në procedimin penal gjerman (Avokati i Përgjithshëm i GJDBE; Gjermani).

- Kërkesat e ndryshme për urdhërimin e një mase të tillë në Francë dhe Gjermani mund të kompensohen me vlerësimin që mund ti bëhet shqyrtimit të përdorimit të provave në gjykatë (Gjermani).

- Nuk do të konsiderohet shkak për përjashtimin e marrjes së provave detyrimi që mund të kenë autoritetet franceze për të informuar në kohë autoritetet gjermane në lidhje me veprimet hetimore të vëzhgimit në territorin federal, duke pasur parasysh miratimin e mëvonshëm të përdorimit të të dhënave nga të gjitha palët (Avokati i Përgjithshëm i GJDBE; Gjermani).

- Nuk ngre asnjë shqetësim ligjor fakti që Prokuroria e Përgjithshme në Frankfurt ka kërkuar një transferim të të gjithë provave në procedimet kundër personave të panjohur (pra jo vetëm për rastin konkret-shënim i autorit) bazuar në një dyshim që ishte i përgjithshëm, por që në fund të fundit do të zbatohej për çdo rast konkret për secilin përdorues (Gjermani).

- Pranueshmëria ose jo e materialeve si provë në gjykatën e vendit lëshues si Franca nuk përbën kusht për marrjen e tyre nga vendi pritës (Norvegji);

- Përdorimi i dokumenteve të transmetuara, në fakt, nuk kushtëzohet nga një vlerësim i gjyqtarit te brendshëm në lidhje me rregullsinë e mënyrës së marrjes së të dhënave të kryera nga autoriteti i huaj, pasi në këtë rast zbatohet prezumimi i legjitimitetit të veprimtarisë së kryer(Avokati i Përgjithshëm i GJDBE; Itali, Holandë).

- Garantimi i të drejtave themelore të njeriut i takon kryesisht shtetit anëtar lëshues, i cili presupozohet se është respektues i legjislacionit të BE, sidomos të të drejtëve themelore të njeriut (Avokati i Përgjithshëm i GJDBE; Itali).

- Mbrojtja ka barrën e provës të provojë mungesën e përputhshmërisë së procedurave të autoriteteve gjyqësore të huaja

me ato të sistemit të brendshëm, sidomos kur bëhet fjalë, si në rastin konkret, me legjislacionin një vendi anëtar të BE (Itali).

Ndihma e Ndërsjelltë Juridike

- Mbledhja e provave nuk cenon vlerat themelore të të drejtave të njeriut ose evropiane ose kërkesave themelore kushtetuese në kuptimin e një "*ordre public*" që duhet të marr parasysh në ndihmën e ndërsjelltë juridike (Gjermani).

- Mungesa e një kërkese zyrtare në formë shkresore për transferimin e të dhënave midis agjencive ligjzbatuese sipas Urdhrit Evropian të Hetimit nuk konsiderohet shkelje ligjore (Gjermani).

- Përdorimi i të dhënave që rrjedhin nga kjo formë shkëmbimi të dhënash nuk mund t'i nënshtrohet kërkesave më të rrepta se ato që zbatohen për përdorimin e të dhënave të marra nëpërmjet një Urdhri Evropian Hetimi (Gjermani).

- Kërkesa për të këto të dhëna nga autoritetet vendase nuk është bërë për hetimet që do të zhvillohen në një shtetet tjetër të BE (Avokati i Përgjithshëm i GJDBE; Itali).

E drejta për një proces të rregullt ligjor (Neni 6 i KEDNJ

- Procesi i rregullt ligjor kërkon që mbrojtja të ketë akses në dokumentacionin i cili shpjegon mënyrën e marrjes se mesazheve të koduara (Itali).

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ)

- Nuk jemi përballë shkeljes se nenit 8 të KEDNJ pasi nuk kemi të bëjmë me përgjim por me kapje të dhënash (Francë).

- Pajisja është vendosur jo për të përgjuar por për të parandaluar lëvizjen e mesazheve të koduara (Francë).

- Vendosja e pajisjeve të tilla lejohet vetëm kur kemi të bëjmë më hetime të veprave penale në kuadër të krimit të organizuar (Francë).

- Në marrjen e të dhënave duhet të merret të merret parasysh parimi i proporcionalitetit i cili duhet të vlerësohet nga gjykatat e brendshme të shtetit lëshues (Avokati i Përgjithshëm i GJDBE, Gjermani).

- Hetimet nga autoritetet franceze nuk kishin të bënin me një vëzhgim masiv/të përgjithshëm të kryer pa shkak dhe që përfshinte një numër të madh përdoruesish të telefonave celularë dhe për të cilat nuk ekzistonte asnjë dyshim për ta (Gjermani).

- Të dhënat e marra në këtë mënyrë mund të përdoren për të dënuar autorët që kanë kryer vepra penale veçanërisht të rënda, për hetimin e të cilëve, gjykata mund të lejojë përdorimin e teknikave hetimore të cilat mund të jenë edhe më ndërhyrëse në jetën private dhe të cilat janë të parashikuara nga legjislacioni procedural penal (Gjermani).

Dr. Iv Rokaj

VËSHTRIM KRAHASUES MBI ASPEKTE KRIMINALOGJIKO-PENALE TË KRIMEVE KIBERNETIKE: CYBER-BULLYING DHE CYBER-STALKING

HYRJE

Zona dixhitale ka ndihmuar në avancimin e teknologjisë me përfitime të shumta në jetën e përditshme, por kjo mënyrë dixhitale e komunikimit i ka bërë edhe "ngacmimet dhe shqetësimet" më të shpeshta dhe të pazbuluara. Në përgjithësi, termi bullizëm barazohet me konceptin e ngacmimit, i cili është një formë e agresionit i paprovokuar që shpesh drejtohet në mënyrë të përsëritur ndaj një individi ose grupi tjetër individësh. Ngacmimi kibernetik është një ngacmim që ndodh nëpërmjet përdorimit të pajisjeve dixhitale, si telefonat celularë, kompjuterët dhe tabletët. Ngacmimi kibernetik mund të dëmtojë reputacionin online të të gjithëve atyre që janë të përfshirë – jo vetëm të personit që ngacmohet, por edhe atyre që bëjnë ngacmimin ose marrin pjesë në të. Nga ana tjetër, sulmi kibernetik është një lloj krimi kibernetik që përdor internetin dhe teknologjinë për të ngacmuar ose përndjekur një person. Mund të konsiderohet një shtrirje e bullizmit kibernetik dhe ndjekjes personale.

Termi bullizëm barazohet me konceptin e ngacmimit, megjithatë ngacmimi tenton të bëhet më "tinëzar" pasi vazhdon me kalimin e kohës dhe mund të barazohet më mirë me dhunën sesa me ngacmimin. Prandaj, Erling Roland shprehet se ngacmimi është "dhunë e gjatë, fizike ose psikologjike, e kryer nga një individ ose një grup i drejtuar kundër një individi që nuk është në gjendje të mbrohet në situatën aktuale"[1].

1 Roland, E. (1989). "Bullying: The Scandinavian Research Tradition." In Bullying in Schools, edited by Delwyn P. Tattum and David A. Lane, 21–32. Stroke-on-Trent, UK: Trentham, faq 11.

STRUKTURA E PUNIMIT

Ky punim do të strukturohet në kapituj dhe nënkapituj si më poshtë. Pas pjesës hyrëse, ku do të jepet një prezantim i përgjithshëm i punimit, pasqyrës së lëndës, metodologjisë së përdorur në punim dhe identifikimit të pyetjeve kryesore të cilat shtrohen për përgjigjie, tema do të zhvillohet më tej me ndarje me kapituj dhe nënkapituj.

Kapitulli i parë do të synojë të identifikojë, përshkruajë bullizmin kibernetik dhe përndjekjen kibernetike si vepër penale dhe gjithashtu si fenomene të reja dixhitale që kërkojnë mjete të reja për identifikimin dhe parandalimin e tyre.

Kapitulli i dytë do të trajtojë pse përndjekja kibernetike dhe bullizmi kibernetik nuk mund të shmangen dhe të luftohen me metoda tradicionale, të cilat me sa duket nuk janë më efikase. Ky kapitull do të trajtojë natyrën dhe ndikimin e saj në mendësinë e viktimës, në mënyrë që ky studim mund të ndihmojë në gjetjen e disa mjeteve më efikase për parandalimin e një sulmi të tillë në internet.

Kapitulli i tretë do të fokusohet kryesisht në aspektet kriminalogjike të këtyre krimeve kibernetike, por duke analizuar motivet dhe qëllimet e autorëve, ndryshimet sociale në jetën e viktimave, amplitudën e përhapjes së këtyre dukurive dhe përfitimet sociale që mund të arrihen nëpërmjet burgimit apo formave të tjera të dënimit penal, etj.

Kapitulli i katërt do të përpiqet të krahasojë dhe analizojë legjislacione të ndryshme në lidhje me bullizmin kibernetik dhe përndjekjen kibernetike, për të krijuar udhëzues më të mirë në luftën kundër këtyre fenomeneve. Legjislacione të ndryshme kanë zhvilluar arsyetime dhe perceptime të ndryshme për këto krime kibernetike dhe për rrjedhojë një studim krahasues i tyre mund të nxisë diskutime të reja për ndryshime të mundshme dhe të nevojshme legjislative në legjislacionin shqiptar, duke pasur parasysh faktin qe aktualisht po punohet për një draft për miratimin e Kodit te Ri Penal të Republikës së Shqipërisë pas më shumë se 18 vitesh që prej miratimit të kodit aktual në vitin 1995.

Në fund do të përfundojmë duke theksuar aspektet kryesore dhe duke identifikuar disa rekomandime legjislative dhe praktike për luftën në të ardhmen ndaj këtyre krimeve kibernetike.

METODOLOGJIA E PERDORUR

Metodologjia e përdorur për këtë punim shkencor mbi cyber-bullying dhe cyber-stalking, përfshin disa nga metodat e mëposhtme:

1. Metoda analitike: Përdorimi i saj për të shqyrtuar më në detaje elementët e bullzmit kibernetik dhe përndjekjes kibernetike duke analizuar më në thellësi aspektet ligjore, kriminalogjike, si dhe fenomenin, nëpërmjet identifikimit të elementëve thelbësorë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

2. Metodologjia intervistuese (për aq sa mund të jetë e mundur): Realizimi i intervistave me viktimat e cyber-bullying dhe cyber-stalking për të kuptuar përvojën e tyre, ndikimin e këtyre fenomeneve dhe strategjitë e përdorura për t'i përballuar ato. Gjithashtu në këtë metode përfshihet edhe studimi i rasteve, pra analiza e rasteve konkrete të cyber-bullying dhe cyber-stalking për të identifikuar mënyrat e veprimit, pasojat dhe masat e ndërmarra nga autoritetet ose individët për të mbrojtur viktimat.

3. Metoda kualitative përmbajtësore: Analiza e materialeve të shkruara, si forume online, blogje dhe komente në artikuj që lidhen me cyber-bullying dhe cyber-stalking, për të nxjerrë tema, tendenca dhe opinionet e ndryshme të shoqërisë. Gjithashtu këtu përfshihet edhe analiza e mediave sociale (për aq sa është e mundur): Hulumtimi i komenteve, postimeve dhe sjelljeve në platforma të ndryshme të mediave sociale për të kuptuar shprehjen e cyber-bullying dhe cyber-stalking në këto mjedise dhe për të ndërtuar një perceptim të gjerë të fenomeneve.

4. Metoda kuantitative: Kërkimet kuantitative përdorin shifrat dhe statistika për të shpjeguar dhe provuar hipoteza duke përdorur anketa,

studime ndërkombëtare, dhe analiza të ndryshme statistikore.

5. Metoda komparative: Përfshin krahasimin e disa rasteve apo legjislacioneve për të identifikuar ngjashmësi dhe dallimet, duke kërkuar të gjejë shkaqet dhe pasojat e tyre.

Kombinimi i disa prej këtyre metodologjive do të ofroje një perspektivë të pasur dhe të kompletuar mbi cyber-bullying dhe cyber-stalking.

Disa pyetje shkencore që mund të adresohen për të eksploruar dhe analizuar cyber-bullying dhe cyber-stalking janë:

1. Si përcaktohet cyber-bullying dhe cyber-stalking? Çfarë ndryshimesh ka ky format digjital me formën tradicionale të bullizmit dhe perndjekjes?

2. Cilat janë formët më të zakonshme të cyber-bullying dhe cyber-stalking? Si ndikojnë ato në individët dhe shoqërinë në përgjithësi?

3. Cilat janë karakteristikat e viktimave dhe të autorëve të cyber-bullying dhe cyber-stalking? Çfarë i shtyjnë ata të bëjnë këto veprime?

4. Si ndryshojnë kulturat dhe konteksti social në manifestimin dhe trajtimin e cyber-bullying dhe cyber-stalking?

5. Cilat janë pasojat e cyber-bullying dhe cyber-stalking në shëndetin mendor dhe emocional të viktimave? Si ndikojnë këto fenomene në përgjithësi në marrëdhëniet sociale?

6. Cilat janë strategjitë dhe mjetet e përdorura për të parandaluar, monitoruar dhe trajtuar cyber-bullying dhe cyber-stalking? A janë efikase ato dhe si mund të përmirësohen?

7. Si ndikojnë ligjet dhe politikat e ndryshme në nivel vendi dhe ndërkombëtar, në trajtimin e cyber-bullying dhe cyber-stalking? A janë të përshtatshme për t'u kundërpërgjigjur këtyre fenomeneve?

8. Si është e lidhur çështja e privatësisë me cyber-bullying dhe

cyber-stalking? Çfarë politikash dhe masash mund të ndërmerren për të garantuar mbrojtjen e privatësisë në këtë kontekst?

9. Cilat mund të jenë ndryshimet e mundshme dhe të nevojshme legjislative në legjislacionin shqiptar në lidhje me këto vepra penale dhe fenomene, duke pasur parasysh faktin që aktualisht po punohet për një draft për miratimin e Kodit të Ri Penal në Republikën e Shqipërisë?

KAPITULLI I

Studiuesi skandinav Dan Olweus, një nga studiuesit më në zë në këtë fushë, e përkufizon bullizmin si "sjellje agresive e qëllimshme dhe që përfshin një çekuilibër fuqie, e cila shpesh, përsëritet me kalimin e kohës."[2] Tonja Nansel e përkufizon ngacmimin si sjellje agresive ose "dëmtim" të qëllimshëm nga një person ose një grup personash, i kryer në përgjithësi në mënyrë të përsëritur dhe me kalimin e kohës përfshin një diferencim të fuqisë[3]. Së fundi, Departamenti i Arsimit i Minesotës arsyeton se "përkufizimet e ngacmimit ndryshojnë, por shumica pajtohen se ngacmimi përfshin qëllimin për të dëmtuar, përsëritjen dhe një çekuilibër fuqie midis viktimës dhe agresorit."[4]

Ngacmimi kibernetik është ngacmim që ndodh nepërmjet pajisjeve dixhitale si telefonat celularë, kompjuterët dhe tabletët. Ngacmimi kibernetik mund të ndodhë përmes SMS-ve, tekstit dhe aplikacioneve, ose në internet në media sociale, forume ose lojëra ku njerëzit mund të shikojnë, marrin pjesë ose ndajnë përmbajtje. Ngacmimi kibernetik përfshin dërgimin, postimin ose ndarjen e përmbajtjes negative, të dëmshme, të rreme ose të keqe për dikë tjetër. Mund të përfshijë ndarjen e informacionit personal ose privat për dikë tjetër që shkakton siklet ose poshtërim ndërsa disa ngacmime kibernetike e kalojnë kufirin në sjellje të paligjshme ose kriminale.

Nga ana tjetër, përndjekja kibernetike është një lloj krimi kibernetik që përdor internetin dhe teknologjinë për të ngacmuar ose përndjekur një person. Mund të konsiderohet një shtrirje e bullizmit kibernetik dhe ndjekjes personale. Megjithatë, ajo merr formën e mesazheve me tekst, e-mail, postime në mediat sociale dhe mediume të tjera dhe shpesh

2 Olweus, D., & Limber, S., & Mihalic, S. (1999). "Bullying Prevention Program." In Fight Crime: Invest in Kids. Blueprints for Violence Prevention: Book Nine, edited by Delbert S. Elliott. Boulder, CO: Center for the Study and Prevention of Violence, faq 56.

3 Olweus, D. (1990). "Bullying Among School Children." In Health Hazards in Adolescence, 259–297. Berlin: De Gruyter,faq 234.

4 Minnesota Department of Education. (2014). "Bullying and Cyber-Bullying."

është këmbëngulëse, e qëllimshme dhe metodike.

Përndjekja kibernetike shpesh fillon me ndërveprime në dukje shfaqen si të padëmshme dhe që vazhdojnë të bëhen sistematike në një mënyrë të bezdisshme ose të frikshme. Disa madje e shohin fazën fillestare të ndjekjes kibernetike si argëtuese dhe të padëmshme, por ajo pushon së qeni argëtuese kur ndërveprimet nuk mbarojnë edhe pasi personi ka shprehur pakënaqësinë e tij dhe ka kërkuar që ndërveprimi të ndalet. Përmbajtja që i drejtohet viktimës është shpesh e papërshtatshme dhe shqetësuese. Një sulmues kibernetik mund të terrorizojë një viktimë duke dërguar mesazhe disa herë në ditë dhe nga llogari të ndryshme.

Përndjekja kibernetike nuk përfshin domosdoshmërisht komunikim të drejtpërdrejtë dhe disa viktima mund të mos e kuptojnë se janë viktima të përndjekjes në internet. Viktimat mund të monitorohen me metoda të ndryshme dhe informacioni i mbledhur mund të përdoret më vonë për krime të tilla si vjedhja e identitetit, shantazhi, denigrimi etj.

Disa karakteristika të zakonshme të sjelljes së përndjekjes kibernetike janë gjurmimi i vendndodhjeve, shkelja e privatësisë së të dhënave, monitorimi i aktiviteteve në internet dhe të botës reale, gjurmimi me obsesion i vendndodhjes së viktimave, frikësimi i viktimave, etj. Përndjekja e mediave sociale mund të përfshijë dërgimin e mesazheve kërcënuese private ose falsifikimin e fotografive.

Shpesh, sulmuesit kibernetikë bëjnë akuza të rreme, përhapin thashetheme keqdashëse, krijojnë profile ose bloge të rreme në mediat sociale, ose krijojnë dhe publikojnë imazhe seksuale hakmarrëse, etj.

Shpesh këto sjellje mund të keqkuptohen për shkak se nuk përfshin kontakt fizik dhe përndjekja kibernetike nuk është aq e rëndë sa forma fizike e përndjekjes. Kjo nuk është e vërtetë në të gjitha rastet. Interneti është bërë pjesë integrale e pashmangshme e jetës tonë, qoftë personale apo profesionale dhe bota online vetëm sa ka lehtësuar mënyrën se si zhvillohen komunikimet së bashku me rritjen e aksesit në informacionin personal.

Së dyti, ngacmimi përfshin domosdoshmërisht keqdashje nga

ana e agresorit, dhe se keqdashja është një lloj dhune. Studiuesit janë përpjekur të kategorizojnë lloje të ndryshme të dhunës ngacmuese në mënyra të shumta. Disa janë fokusuar në dallimin midis agresionit të drejtpërdrejtë dhe agresionit indirekt[5]. Agresioni i drejtpërdrejtë përfshin dhunën fizike goditjen, shkelmimin, marrjen e sendeve me forcë dhe dhunën verbale tallje, ngacmim, kërcënim ndersa agresioni indirekt përfshin akte më delikate, manipuluese, të tilla si izolimi, frikësimi ose kontrolli i një personi tjetër. Të tjerë janë fokusuar në dallimin midis formave të hapura dhe të fshehta (relacionale) të ngacmimit[6]. Ngacmimi i hapur mund të përfshijë thirrjen, shtyrjen ose goditjen, ndërsa ai relacional përfshin thashethemet, përhapjen e thashethemeve, sabotimin social, përjashtimin dhe sjellje të tjera shkatërruese për marrëdhëniet ndërpersonale.

Së treti, ngacmimi nuk mjaftohet me një rast sporadik për t'u kualifikuar si bullizëm, pra sjellja duhet të ndodhë, ose të përsëritet[7]. Kjo është një nga veçoritë që e dallon bullizmin nga format e tjera të ngacmimit, megjithatë për shkak se një sjellje lënduese ndodh vetëm një herë, nuk do të thotë se duhet të injorohet ne kuptim social e parandalues, por thjesht do të thotë se nuk është e saktë t'i referohemi atij si bullizëm në kuptimin klasik të tij. Pra arsyeja pse ngacmimi mund të jetë kaq i dëmshëm emocionalisht ose psikologjikisht dhe meriton ndeshkim penal është sepse ai është i përsëritur. Natyra e përsëritur e ngacmimit krijon një dinamikë ku viktima shqetësohet vazhdimisht për atë që ngacmuesi do të bëjë më pas. Në të vërtetë, viktima shpesh ndryshon sjelljet e tij ose të saj të përditshme për të shmangur kontaktin personal me dhunuesin, sepse supozohet se diçka e keqe do të ndodhë

5 Roland, E. (1980). Terror i skolen. Stavanger, Norway: Rogaland Research Institute, faq 45.

6 Po aty

7 Olweus, D., & Limber, S., & Mihalic, S. (1999). "Bullying Prevention Program." In Fight Crime: Invest in Kids. Blueprints for Violence Prevention: Book Nine, edited by Delbert S. Elliott. Boulder, CO: Center for the Study and Prevention of Violence, faq 341.

nëse ata ndërveprojnë[8].

Së katërti, është e natyrshme që në çdo koncept të bullizmit shfaqet demonstrimi ose interpretimi i pushtetit nga autori mbi viktimen. Nëse të dyja palët do të ishin shoqërisht apo fizikisht të barabarta, nuk mund të mendohet se asnjëra ka përparësi mbi palën tjetër. Shumë karakteristika mund t'i japin dhunuesit perceptimin e një pushtet mbi viktimën, duke përfshirë popullaritetin, forcën fizike, kompetencën sociale, zgjuarsinë, besimin, inteligjencën, moshën, seksin, racën, përkatësinë etnike ose statusin socio-ekonomik. Akoma më e rëndësishme në lidhje me këtë punim janë edhe aftësitë teknologjike të cilat në ditët e sotme mund t'i japin një personi pushtet mbi një tjetër. Të rinjtë që janë në gjendje të lundrojnë në internetit ose që dinë të mbulojnë gjurmët e tyre virtuale, janë një hap para atyre që nuk kuptojnë plotësisht ose nuk dinë si t'i konfigurojë siç duhet llogaritë e tyre online ose si të identifikojë autorët e cyber-bullying.

Autorët e këtyre krimeve përdorin një sërë taktikash dhe teknikash për të poshtëruar, ngacmuar, kontrolluar dhe frikësuar viktimat e tyre. Disa shembuj se si mund të ndodh cyber-bullying janë:

- Postimi i komenteve ofenduese, sugjestive ose ofenduese në internet.
- Dërgimi i emaileve ose mesazheve kërcënuese, të turpshme ose fyese për viktimën.
- Anëtarësimi në të njëjtat grupe dhe forume si viktima.
- Publikimi i informacionit konfidencial të viktimës në internet.
- Ndjekja e të gjitha lëvizjeve online të viktimës përmes pajisjeve gjurmuese.
- Përdorimi i teknologjisë për shantazhimin ose kërcënimin e

8 Limber, S., & Nation, M. (1998). "Bullying Among Children and Youth." In Combating Fear and Restoring Safety in Schools, edited by June L. Arnette and Marjorie C. Walsleben. Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention (1998), faq 78.

viktimës.

- Etiketimi i tepërt i viktimës në postime të parëndësishme.
- Angazhimi me të gjitha postimet në internet të bëra nga viktima.
- Krijimi i profileve false në rrjetet sociale për të ndjekur viktimën.
- Postimi ose shpërndarja e fotove reale ose false të viktimës.
- Dërgimi i fotografive eksplicite të viktimës.
- Bërja e postimeve false me qëllim turpërimin e viktimës.
- Dërgimi i mesazheve në mënyrë të përsëritur viktimës.
- Hakimi në llogaritë online të viktimës.
- Përpjekja për të zhvatur foto eksplicite të viktimës.
- Dërgimi i dhuratave apo sendeve të padëshiruara për viktimën.
- Përdorimi i mjeteve të hakerimit për të hyrë në kamerën e laptopit ose të smartfonit të viktimës dhe për t'i regjistruar ato fshehurazi.

Llojet e ndryshme të ndjekjes kibernetike që janë të përhapura janë krijimi i profileve të rreme ose kopjimi i atyre ekzistuese në mediat sociale për t'iu afruar viktimave; monitorimi i kontrolleve në mediat sociale; vëzhgimi i aktiviteteve të një viktime në mediat sociale për të vlerësuar me saktësi modelin e sjelljes së tyre; spiunimi nëpërmjet Google Maps dhe Google Street View; duke përdorur Street View për të spiunuar një viktimë dhe për të gjetur vendndodhjen e saj nga postimet ose fotot në mediat sociale; hakerimi i kamerës nepërmjet internetit; instalimi i stalker-ware për të gjurmuar vendndodhjen, mundësimin e aksesin në historikun e viktimës, bërja e regjistrimeve audio, etj., pa dijeninë e viktimës; gjurmimi i vendndodhjes me gjeo-lokacionit e fotove dixhitale gjë që e bën më të lehtë për autorët qasjen në informacionin duke përdorur aplikacione të veçanta.

Përndjekja kibernetike nuk ndryshon nga ndjekja dhe çon në pasoja që mund të jenë të dëmshme për viktimat si fizikisht ashtu

edhe mendërisht. Viktimat që ngacmohen në internet përjetojnë frikë, zemërim, konfuzion dhe pagjumësi së bashku me çështje të tjera shëndetësore. Përndjekja kibernetike ndikon në mirëqenien e përgjithshme të viktimave. Ata shpesh vuajnë nga ankthi, shqetësimi, depresioni, PTSD[9] dhe idetë vetëvrasëse.

Në përgjithësi, ngacmimi kibernetik përfshin dërgimin ose postimin e teksteve dhe/ose imazheve të dëmshme ose mizore duke përdorur internetin ose pajisje të tjera komunikimi dixhitale, si telefonat celularë. Ngacmimi kibernetik mund të ndodh në faqet e internetit personale ose mund të transmetohet nëpërmjet postës elektronike, faqeve të rrjeteve sociale, tabelave të mesazheve dhe mesazheve të çastit ose telefonave celularë.

Llojet e bulizmit kibernetik[10].

Shumica e ngacmimeve kibernetike bien në një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:

1. Flaming: Lufton online duke përdorur mesazhe elektronike me gjuhë urretje dhe vulgare.
2. Ngacmimi dhe ndjekja: Dërgimi i vazhdueshëm i mesazheve mizore, të egra dhe/ose kërcënuese.
3. Denigrim: Dërgimi ose postimi i thashethemeve rreth një personi për të dëmtuar reputacionin e tij ose të saj.
4. Imitim: Depërtimi në llogarinë e postës elektronike të dikujt dhe përdorimi i tij për të dërguar të mbrapshtë ose të turpshëm materiale për të tjerët.
5. Mashtrime të ndryshme: Angazhimi i dikujt në mesazhe të çastit, duke e mashtruar atë për të zbuluar ndjeshmërinë informacion, dhe përcjellja e atij informacioni te të tjerët
6. Përjashtim: Përjashtimi i qëllimshëm i dikujt nga një grup në internet.

9 Post Traumatic Stress Disorder- Çrregullime të stresit post-traumatik

10 Willard, 2007.

Ngacmuesit kibernetikë kanë po aq gjasa të jenë femra sa meshkuj dhe kanë më shumë gjasa të jenë adoleshente më të moshuar sesa më të rinj. Në mënyrë të ngjashme me ngacmuesit tradicionalë, ngacmuesit kibernetikë priren të kenë marrëdhënie të dobëta me kujdestarët e tyre. Ata kanë më shumë gjasa se jo ngacmuesit të jenë objektiva të ngacmimit tradicional dhe të përfshihen në sjellje delikuente dhe në përdorimin më të shpeshtë të substancave. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa të jenë përdorues të shpeshtë të përditshëm të internetit.

Një ngacmues kibernetik mund të jetë ose jo një person që viktima njeh. Ngacmuesit kibernetikë shpesh mund të mbeten anonim, duke e bërë të vështirë nëse jo të pamundur të dallosh se kush është dhunuesi. Ata mund të punojnë në grup me miqtë e tyre, duke e bërë edhe më të vështirë përcaktimin se kush po sulmon. Megjithëse nuk ka prova të qarta që të rinjtë që përfshihen në ngacmime tradicionale janë gjithashtu të prirur ndaj ngacmimit kibernetik, duket se disa viktima të ngacmimit fizik përfshihen në bullizëm kibernetik si një formë hakmarrjeje ndaj torturuesve të tyre.

Programi STOP Cyberbullying[11] përshkruan katër lloje kryesore të bullizmit kibernetik:

1. "Engjëlli hakmarrës" nuk e sheh veten si një ngacmues, por më tepër si një vigjilent, pasi ai ose ajo shpesh përfshihet duke u përpjekur të mbrojë një mik që po ngacmohet ose ngacmohet në internet.
2. Ngacmuesit kibernetikë "të uritur për pushtet" duan të ushtrojnë autoritetin e tyre dhe të kontrollojnë të tjerët me frikë, dhe ata shpesh janë viktima të ngacmimeve tradicionale. Disa njerëz e quajnë këtë "Hakmarrja e Nerds" bullizëm kibernetik, sepse këta ngacmues janë shpesh aq fizikisht të vegjël dhe të shënjestruar nga bashkëmoshatarët e tyre për shkak se nuk janë „cool" ose të aftë teknologjikisht.
3. Ngacmimi kibernetik i "Vajzave të këqija" ndodh shpesh në një grup. Autorët zakonisht mërziten dhe kërkojnë argëtim.

11 Wired Kids, Inc.

4. “Ngacmuesit e paqëllimshëm” kibernetikë nuk synojnë të shkaktojnë dëm, ata thjesht përgjigjen pa menduar për pasojat e veprimeve të tyre.

Në lidhje me dallimet midis bullizmit kibernetik dhe bullizmit tradicional themi se ato nuk janë shumë të dukshme për shkak të ngjashmërive në teknika. Edhe pse ngacmimi kibernetik dhe ngacmimi tradicional sjellin dëm dhe trajtim ndaj viktimave, ngacmimi kibernetik lejon që dhunuesi të fshihet pas një ekrani dhe të kryejë bullizmin pa u identifikuar lehtësisht, gjë që lejon anonimitetin. Më pas, ngacmimi kibernetik gjithashtu lejon që informacioni të përhapet me shpejtësi dhe i lejon autorit të aksesojë ngacmimin kudo dhe në çdo kohë. Prandaj, disponueshmëria dhe qasja ndaj ngacmimit janë më të përshtatshme dhe në përgjithësi ndihmojnë aktin.

Në përgjithësi, ngacmimi tradicional ka një shkallë më të lartë prevalence në krahasim me ngacmimin kibernetik. Kjo për shkak se ngacmimi kibernetik është relativisht i ri për shoqërinë dhe kërkimet e bëra janë të kufizuara. Çështja e bullizmit kibernetik pritet të rritet pasi adoleshentët rritën kohën e tyre të kaluar në internet dhe përdorimin e telefonit celular.

Përveç kësaj, shumë e kanë të vështirë të bëjnë dallimin midis një shakaje të pafajshme dhe ngacmimit kibernetik. Meta-analiza e fundit tregoi se ngacmimi kibernetik lidhet fuqishëm me idetë vetëvrasëse në krahasim me ngacmimet tradicionale, duke shkaktuar më shumë efekt negativ tek viktimat.

Përveç kësaj, vëmendja e prindërve luan një rol jetik në identifikimin e bullizmit kibernetik dhe bullizmi tradicional. Gjeneratat e vjetra janë kryesisht më pak të aftë për teknologjinë në krahasim me gjeneratat e reja, gjë që më pas ndikon në efikasitetin në zbulimin dhe realizimin e aktiviteteve të ngacmimit kibernetik. Për shkak të kësaj, mungon frika ndaj ndëshkimeve për bullizmin, gjë që mund të kontribuojë në rritjen e shkallës së bullizmit kibernetik.

KAPITULLI II

Kapitulli i dytë do të trajtojë pse përndjekja kibernetike dhe bullizmi kibernetik nuk mund të shmangen dhe të luftohen me metoda tradicionale, të cilat me sa duket nuk janë më efikase. Ky kapitull do të trajtojë natyrën dhe ndikimin e saj në mendësinë e viktimës, në mënyrë që ky studim mund të ndihmojë në gjetjen e disa mjeteve më efikase për parandalimin e një sulmi të tillë në internet.

